REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

# DOKUMENTI
# I STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT
# TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
# 2014-2020

**(Draft)**

**Tiranë, 2014**

**© Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Përmbajtja e këtij dokumenti mbrohet nga ligji për të drejtën e autorit. Ministria nxit shpërndarjen e pjesëve të veçanta për përdorim të brendshëm ose personal, si dhe për qëllime të tjera jofitimprurëse.

**Redaktor shkencor:**
Prof. Asc. Dr. Pëllumb KARAMETA

**Redaktor gjuhësor:**
Dr. Besnik RAMA

# DOKUMENTI I STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2014-2020

**(Draft)**

**Tiranë, 2014**

# Përmbajtjet


Fjala e ministrit ........................................................................................................................ 8

Hyrje ........................................................................................................................ 10

**SEKSIONI 1. SITUATA AKTUALE NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR** ......... 12

Organizimi dhe funksionimi ........................................................................................ 13

Paraqitje e kontekstit të përparësive – sfidat përpara.................................................................... 17

Kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese ........................................................................ 17

Cilësia e arritjeve dhe niveli i kushteve të nxënies ........................................................ 21

Sigurimi i cilësisë së arritjeve .................................................................................... 26

Problematika e burimeve njerëzore ............................................................................ 28

**SEKSIONI 2. VIZIONI, DHE QËLLIMI POLITIK**......................... ........................................... 31

Vizioni ........................................................................................................................ 32

Qëllimi politik ........................................................................................................... 32

Përparësitë e politikës ................................................................................................ 32

**SEKSIONI 3. OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE REZULTATET KRYESORE** ................ 34

Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve .......................... 35

Nxënie gjithëpërfshirëse dhe cilësore.......................................................................... 42

Sigurimi i cilësisë së arritjeve bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së ..................... 48

Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve ..................................... 51

**SEKSIONI 4. BURIMET FINANCIARE SIPAS PËRPARËSIVE TË POLITIKËS**.................. 56

Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të kapaciteteve dhe burimeve .......................... 59

Nxënia cilësore dhe gjithëpërfshirëse ........................................................................ 60

Sigurimi i cilësisë së arritjeve bazuar në standarde ..................................................... 61

Përgatitja dhe zhvillimi profesional ........................................................................... 61

**SEKSIONI 5. RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI** ................................................ 61

Korniza e monitorimit ................................................................................................ 62

Korniza e vlerësimit të performancës ........................................................................ 63

**SHTOJCA 1:** Treguesit për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së strategjisë ............................... 66

**SHTOJCA 2:** Plani për zbatimin e strategjisë ........................................................... 70

**SHTOJCA 3:** Bashkëpunime dhe partneritete në arsim ................................................ 91

# LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA

| | |
|---|---|
| AFP | Arsimi dhe Formimi Profesional |
| AKP | Agjencia Kombëtare e Provimeve |
| AK | Aftësi të Kufizuara |
| AKFAL | Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë |
| APU | Arsimi Parauniversitar |
| APSh | Arsimi Parashkollor |
| BE | Bashkimi Europian |
| DAR | Drejtoria Arsimore Rajonale |
| FE | Fakulteti i Edukimit |
| IA | Institucion Arsimor |
| IShA | Inspektorati Shtetëror i Arsimit |
| IZhA | Instituti i Zhvillimit Arsimit |
| IS | Instituti Special |
| KK | Korniza Kurrikulare |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MBP | Menaxhimi në Bazë të Performancës |
| MF | Ministria e Financave |
| ME | Ministria e Ekonomisë |
| MMSR | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë |
| MM | Ministria e Mjedisit |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| NjBQV | Njësia Bazë e Qeverisjes Vendore |
| PVNN | Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve |
| OECD | Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim |
| OJF | Organizatë Jofitimprurëse |
| PPB | Produkti Përgjithshëm Bruto |
| PISA | Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve |
| SAPU | Sistemi Arsimor Parauniversitar |
| SMIA | Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim |
| SMIS | Sistemi i Menaxhimit të Infrastrukturës Shkollore |
| SZhAPU | Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar |
| TIK | Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| ZA | Zyra Arsimore |
| ZhP | Zhvillimi Profesional |

## ❖ KONTRIBUAN:

### ➢ Për hartimin e kornizës konceptuese

| | | |
|---|---|---|
| Lindita | NIKOLLA | Ministër |
| Nora | MALAJ | Zëvendësministër |
| Adriana | BERBERI | MAS |

### ➢ Për hartimin e dokumentit të Strategjisë

| | | |
|---|---|---|
| Pëllumb | KARAMETA | MAS |
| Yllka | SPAHIU | IZhA |
| Agim | LEKA | MAS |
| Florian | NURÇE | MAS |
| Erjon | NDROQI | MAS |
| Besjona | DEDE | MAS |
| Rezana | VRAPI | AKP |
| Zamira | GJINI | MAS |
| Gerti | JANAQI | IZhA |
| Mirela | BIMO | MAS |
| Ornela | KOLEKA | MAS |
| Sokol | YMERI | MAS |
| Ermal | ELEZI | MAS |
| Vladimir | GJONI | MAS |
| Dorina | RRAPTI | IZhA |
| Erida | KOLECI | IZhA |
| Elvira | BAZE | MAS |
| Albana | MARKJA | IZhA |
| Majlinda | HALA | IZhA |
| Aurela | ZISI | IZhA |
| Mirela | GURAKUQI | IZhA |
| Mimoza | MILO | IZhA |

| | | |
|---|---|---|
| Mirela | ANDONI | IZhA |
| Bashkim | MUÇA | IShA |
| Teuta | ÇOBAJ | IShA |
| Ejona | ISUFAJ | IShA |
| Eva | HOXHA | IShA |
| Eniana | VELI | IShA |
| Mirela | KONDILI | IShA |
| Arjola | BYZYKA | DAR Tiranë |
| Irini | JANI | DAR Tiranë |
| Kristaq | GRABOCKA | DAR Korçë |
| Nikolin | GERMENJI | DAR Korçë |
| Taulant | RROKO | DAR Korçë |
| Selman | HODAJ | DAR Berat |
| Majlinda | XHAMO | DAR Berat |
| Fiqiri | ÇIFLIKU | DAR Berat |

# Fjala e ministrit

Dokumenti i Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar paraqet vizionin për arsimin që dëshirojmë për fëmijët dhe të rinjtë tanë dhe skicon rrugën për përmbushjen e tij, përmes plotësimit të përparësive strategjike që kemi caktuar për këtë sektor. Sikundër mund të konstatoni, strategjia e trajton sistemin arsimor në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe i adreson konkretisht këto përparësi. Njëherazi, ajo reflekton konsensusin ndërmjet komunitetit akademik, profesionistëve të arsimit, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë.

Për zhvillimin e kësaj Strategjie mësuam nga dobësitë dhe përfituam nga arritjet. U fokusuam mbi gabimet e së shkuarës: theksi i pamjaftueshëm mbi cilësinë dhe rezultatet e nxënies, hartimi i projekteve tepër komplekse që tejkaluan kapacitetet e sistemit/institucionit ose përqendrimi shumë i ngushtë mbi një nënsektor të vetëm, të izoluar nga pjesa tjetër e sistemit arsimor, zgjerimi i infrastrukturës fizike, por pa shqetësimin e duhur për veprimtaritë dhe politikat që përcaktojnë rezultatet e nxënies. Për pasojë, rezultatet arsimore të nxënësve tanë nuk janë ato që do të dëshironim të ishin.

Sot, pranojmë të gjithë se performanca e sektorit arsimor është përcaktuese e rëndësishme e aftësive konkurruese dhe e rritjes ekonomike të kombit; se arsimi është investimi që ndikon thelbësisht zhvillimin tërësor të vendit; se ai është një nga faktorët e rëndësishëm për zhdukjen e varfërisë.

Me këto në mendje, Strategjia shpreh përkushtimin tonë për të zgjedhur çfarë është më e rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve tanë, duke pranuar se, në një botë që ndryshon shpejt, sfida që duhet të përballim është ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke respektuar, njëherazi, dallimet vetjake.

Dokumenti i Strategjisë mban parasysh se shoqëria shqiptare po evoluon dhe po përgatitet për të sfiduar devijimet që e pështjelluan jo pak, duke riorganizuar themelet dhe ripërcaktuar qëllimet arsimore dhe përparësitë e saj strategjike në këtë sektor. Kjo kërkon që të zhvillojmë një vizion imponues për nxënien dhe arsimin, ta komunikojnë me pasion dhe të mundësojnë që ai të përmbushet në të gjitha nivelet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Strategjia e re orienton politikat afatmesme dhe afatgjata sektoriale për përsosjen e APU-së, sipas vizionit të Qeverisë. Në këtë kontekst, Strategjia mbështet dhe unifikimin e sistemeve arsimore të Shqipërisë dhe të Kosovës. Dokumenti, kështu, konkretizon angazhimin profesional të specialistëve tanë dhe mundëson dialogun ndërmjet aktorëve për të ndërtuar një sistem arsimor cilësor dhe të respektuar në nivel ndërkombëtar. Si i tillë, ai është kyçi për projekte konkrete në arsim.

Ndërkohë, jemi të vetëdijshëm dhe kemi kuptuar se për zhvillimin e sistemit nuk ka zgjidhje të lehta dhe të shpejta. Ndryshimeve do t’u qasemi hap pas hapi, duke përfshirë në këtë proces të gjithë

faktorët shoqërorë të interesuar. Ndaj, jam besimplotë se, gjithë sa ofrohet në këtë dokument, do të mundësojë që hapësira arsimore shqiptare të integrohet në hapësirën europiane dhe të ndajë kualitete, vlera dhe qëndrime të njëjta me të.

Në këtë moment, falënderimet e mia të përzemërta shkojnë tek të gjithë kontribuuesit e zhvillimit të Strategjisë. Njëherazi, ftoj dhe shpresoj se të gjithë të interesuarit dhe partnerët tanë do të mbështetin procesin e zbatimit të Strategjisë.

**LINDITA NIKOLLA**

**Ministër i Arsimit dhe Sportit**

Tiranë, më 26.01.2015

# Hyrje

***"Jepu njerëzve lëmoshë apo një mjet pune, ata do të jetojnë pak më mirë. Jepu atyre arsim, ata do të ndryshojnë botën"***

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (në vijim, SZhAPU)(1) është një nga përbërësit e Planit Strategjik të Arsimit 2014-2020. Ajo plotëson aspektet e pa përmbushura të strategjisë 2009-2013 dhe mbështet përsosjen e mëtejshme të sistemit arsimor(2) që vlerësohet si një nga promotorët e zhvillimit të vendit dhe të përpjekjeve tona integruese. Dokumenti i Strategjisë parashtron përparësitë arsimore kombëtare për periudhën në fjalë dhe përbën, kështu, një platformë gjithëpërfshirëse, brenda së cilës të mund të kontribuojnë aktorët institucionalë dhe grupet e interesuara. Dokumenti është propozim për transformimin, për reformimin dhe për zhvillimin e arsimit tonë, sipas një modeli të frytshëm planifikimi, menaxhimi dhe vlerësimi. Ai merr parasysh parimet dhe praktikat më të mira, trajton gjendjen e SAPU-së dhe propozon ndërhyrjet për secilën prej përparësive të vlerësuara si më të rëndësishme, duke shmangur, njëherazi, përshkrimet e panevojshme.

Strategjia e hartuar pajtohet me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Europë dhe në botë. Si e tillë, ajo synon: (i) të përmirësojë cilësinë e arsimit për të gjithë; (ii) të identifikojë veprimtaritë kryesore dhe të planifikojë buxhetet e nevojshme; (iii) të ndihmojë bashkëpunimin mes agjencive qeveritare, partnerëve tanë dhe grupeve të tjera me interes ndaj arsimit, në drejtim të shtrirjes së veprimtarive dhe të investimeve në arsim, në kufijtë e një kuadri të njësuar konceptimi, planifikimi dhe financimi. Bazuar në këtë dokument, zhvillohen planet operuese për secilin vit, në të cilët përcaktohen objektivat vjetorë, veprimtaritë konkrete dhe mjetet / burimet përkatëse.

Puna për hartimin e Strategjisë ka filluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (në vijim, Ministria), në prillin e vitit 2014. Gjatë periudhës prill-gusht 2014, u përgatit "Raporti Paraprak për Reformën e SAPU-së". Nga diskutimi i gjetjeve dhe i propozimeve të Raportit u përftua korniza e konceptimit të Strategjisë, objektivat dhe pritshmëritë sipas përparësive të përcaktuara. Në periudhën shtator-dhjetor, u thellua kërkimi për të njohur dhe evidencuar gjendjen në sistem, në aspektet e veprimtarisë së tij. Në vitin 2014, u organizuan tre workshope, në të cilët ekspertë vendas dhe të huaj, mësues, përfaqësues të organizatave të ndryshme dhe shoqëria civile kanë kontribuar si në identifikimin e pikave të forta / problemeve / vështirësive, ashtu dhe në zhvillimin e kornizës konceptuese. Këto veprimtari u shoqëruan me ngritjen e ekipeve që shtjelluan aspektet e veçanta të Strategjisë.

---

(1) Në këtë strategji nuk përfshihet arsimi dhe formimi profesional, pasi strategjinë e tij e ka zhvilluar MMSR-ja. [MMSR (2014), "*Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020*"]

(2) MASH (2009), "*Strategjia Kombëtare e APU-së 2009 - 2013*".

Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e veprimtarive të parashtruara në SZhAPU, janë respektuar kërkesat thelbësore për një proces të tillë planifikues: *gjithëpërfshirja* (kontributi dhe autorësia mbi produktin e një numri të madh ofruesish dhe përfituesish), *koherenca* (ndërmjet niveleve të arsimit parauniversitar dhe të arsimit të lartë, përmes përfshirjes së ekspertëve nga secili nënsektor), *ekspertiza* dhe *komunikimi*.

SZhAPU-ja është orientuar nga përparësitë e *Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020*. Për hartimin e saj janë konsultuar, gjithashtu, strategjitë tona të mëparshme, ato të Kosovës, *"Korniza Strategjike për Bashkëpunimin në Arsim dhe Trajnim - Europë 2020"* dhe *"Strategjia Europiane e Arsimit 2020"*. Dokumenti i SZhAPU-së është dakordësuar me të gjithë ekspertët e agjencive vartëse të Ministrisë. Ai është bërë objekt diskutimi publik dhe ka përfituar nga kontributet e mjaft të interesuarve.

Dokumenti integron 5 seksione.

Në seksionin 1, shtjellohet *kushtet aktuale* në sistemin e arsimit parauniversitar (organizimi dhe funksionimi i tij) dhe paraqitet një sintezë e *pikave të forta* dhe e *vështirësive* që lidhen me kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese të sistemit, me cilësinë dhe nivelin e kushteve të nxënies, me sigurimin e cilësisë së arritjeve dhe me burimet njerëzore në APU.

Në seksionin 2, shpaloset *vizioni, politikat* dhe *qëllimet strategjike*.

Në seksionin 3, shtjellohen *objektivat e politikes* dhe *produktet kryesore.* Si objektiva të politikës, në këtë Strategji përcaktohen:

*A.* Përmirësimi i qeverisjes, i udhëheqjes dhe i kapaciteteve menaxhuese të burimeve të SAPU-së.
*B.* Nxënia gjithëpërfshirëse[(3)]cilësore.
*C.* Sigurimi i cilësisë së arritjeve bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së.
*D.* Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve.[(4)]

Në seksionin 4, parashtrohen burimet financiare - *implikimi financiar mbi kuadrin ekonomik*.
Në seksionin 5, janë paraqitur *elementet e sistemit të raportit, të monitorimit dhe të vlerësimit* të progresit të Strategjisë.

---

(3) Nxënia gjithëpërfshirëse - qasje ku të gjithë fëmijët nxënë bashkë në shkollën më të afërt të rregullt, pa dallime race, gjinie, etnie, aftësie të kufizuar apo ndonjë dallim tjetër, nxënie që nënkupton vendosjen e fëmijës në shkollë dhe organizimin e mbështetjes efikase, sipas nevojave individuale.

(4) Sipas OECD-së, pjesa më e madhe e reformave të analizuara fokusohen në: (i) mbështetjen e fëmijëve të pafavorizuar dhe kujdesin për fëmijërinë e hershme; (ii) reformimin e sistemeve të arsimit profesional dhe krijimin e lidhjeve me punëdhënësit; (iii) përmirësimin e formimit dhe zhvillimit profesional të mësuesve; (iv) forcimin e vlerësimit të shkollës dhe çmuarjen e rezultateve.
[OECD (2015), *Report Launch: Education policy Outlook 2015: Making Reforms Happen*]

# 1 SEKSIONI

## SITUATA AKTUALE

## NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (SAPU)

## ❖ ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Struktura e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë paraqitet në skemën në vijim.




Shqipëria ka një popullsi prej mbi 3 milionë banorësh, prej të cilëve rreth 20%, ose afërsisht 600,000, janë nën moshën 14 vjeç. Pak më shumë se gjysma (52%) e popullsisë jeton në qendrat urbane. Shqipëria renditet e 70-ta nga 187 shtete, sipas Indeksit të Zhvillimit Njerëzor të Programit

të Kombeve të Bashkuara. Të ardhurat për frymë në vitin 2012 u llogaritën në 8,200 dollarë amerikanë duke e renditur Shqipërinë në vendin e 131-të në botë për këtë tregues. Vendi e nxjerr pak më pak se një të pestën (17.5%) e PBB-së së tij nga bujqësia(5).

Sistemi Arsimor Parauniversitar (SAPU) përfshin tri nivele arsimi: *arsimin parashkollor*, *arsimin bazë* (fillor & i mesëm i ulët) dhe *arsimin e mesëm*. Arsimi Parauniversitar (APU) ofrohet në institucione arsimore (IA) publike dhe private.

**Arsimi parashkollor** (APSh) ofrohet në *kopshte* e në *klasa përgatitore* që frekuentohen nga fëmijë të moshave 3 deri 6 vjeç dhe nuk është i detyruar. Kopshtet funksionojnë me tre grupe: grupi i parë (3-4 vjeç); grupi i dytë (4-5 vjeç) dhe grupi i tretë (5-6 vjeç). Klasat përgatitore funksionojnë në shkollat e arsimit bazë dhe frekuentohen nga fëmijë 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor.

Procesi i të nxënit në këtë nivel arsimor zhvillohet në gjuhën shqipe, ndërsa, në kopshtet, që ndodhen në zonat e banuara nga pakicat kombëtare (greke apo maqedonase), ai zhvillohet në gjuhën amtare. Ky proces zhvillohet sipas një kurrikule që konkretizon standardet e miratuara. Numri i kopshteve private përbën 8.4% të numrit të kopshteve dhe numri i fëmijëve që marrin arsimin parashkollor në këto institucione përbën rreth 6% të numrit përgjithshëm.

Edhe pse studimet tregojnë se ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme ka një normë të lartë kthimi në arsimin bazë e më tej, për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje, ritmet e përmirësimit të arsimit parashkollor, në dekadën e fundit, kanë qenë të ngadalta. Fakti që arsimi parashkollor nuk bën pjesë në arsimin e detyruar duket ka kushtëzuar mungesën e vëmendjes së të gjitha Qeverive që pasqyrohet në zvogëlimin e vijueshëm të fondeve që ndahen për arsimin parashkollor. Nëse në vitin 2001 për arsimin parashkollor shpenzohej 5.9% e buxhetit të arsimit, në vitin 2013 ky tregues është 4.6%. Për pasojë, gjendja e ndërtesave të kopshteve dhe pajisja e tyre me orendi dhe mjete didaktike nuk përmbush standardet e përcaktuara. Kërkesat e shumta të prindërve për këtë shërbim, veçanërisht në zonat urbane të prekura nga migrimi, nuk janë plotësuar.

Megjithatë, në raport me numrin total të fëmijëve, përqindja e atyre që frekuentojnë kopshtet shënon rritje. Në vitin 2008, shkonin në kopsht 72600, në vitin 2014 ky tregues arriti në 77154(6). Duhet vënë në dukje se në shifra absolute numri i fëmijëve ka ardhur në rënie si në qytet edhe në fshat, si pasojë e rënies së numrit të lindjeve, të emigracionit si dhe papunësisë së grave.

Tërheqja e fëmijëve në APSh-në në vendin tonë luhatet rreth shifrës 60%, në një kohë kur mesatarja e vendeve europiane është 76%.

(5) Banka Botërore, (2014). *Zhvillimi në fëmijërinë e hershme*. *Shqipëria.* [http://www.worldbank.org/content/dam/worldbank/document/eca/albania/al-saber-al.pdf]

(6) Burimi: Zyra e statistikave në MAS.

Përpjekjet e viteve të fundit janë përqendruar në përmirësimin e kushteve fizike (godinat, pajisjet, mjetet didaktike), në rritjen e cilësisë së nxënies dhe në drejtimin e personelit.

**Arsimi bazë** u ofrohet fëmijëve të moshave mbi 6 vjeç, zgjat 9 vite dhe është i detyruar. Struktura e nivelit fillor, në arsimin e detyruar, ka ndryshuar me planin e ri mësimor të vitit 2004. Në bazë të kësaj strukture, kohëzgjatja aktuale është 5 vjet. Nxënësit i frekuentojnë IA-të që ofrojnë arsim bazë deri në moshën 16 vjeç. Personat që mbushin moshën 16 vjeç, por që nuk arrijnë ta përfundojnë arsimin bazë, mund ta përfundojnë atë në shkollat me kohë të pjesshme. Rreth 92% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë vijojnë në arsimin e mesëm të lartë. Raporti mësues nxënës, për arsimin bazë, është përafërsisht 1:16. Ndërsa, numri i shkollave private, që ofrojnë arsim bazë, përbën 8.5% të numrit të nxënësve. Ato ofrojnë shërbimet e tyre për 7.2% të numrit të përgjithshëm të nxënësve tanë.

*Infrastruktura fizike* nuk i përgjigjet në të gjithë shtrirjen e tij (sidomos në zonat rurale) kërkesave bashkëkohore. I shtohet kësaj dhe mbështetja e pamjaftueshme e procesit mësimor me mjete didaktike, laboratorë (aplikativë ose demonstrativë), pajisja me mobile të përshtatshme në mbështetje të mësimit, etj.

Ka vijuar braktisja e shkollës dhe është e pranishme dukuria e fëmijëve aktualisht jashtë sistemit arsimor, çka ka bërë që arsimin bazë të mos frekuentohet kryesisht nga fëmijët e shtresave në nevojë, sidomos ata romë. Aktualisht, në Shqipëri ka rreth 5000 fëmijë romë të moshës 3-16 vjeç. Niveli i regjistrimit të fëmijëve në shkollë, në moshën e caktuar sipas ligjit, është i ulët, ndërsa 1 në 2 fëmijë romë në moshë shkolle e ka braktisur shkollën. Fenomeni bëhet edhe më shqetësues për vajzat rome dhe për fëmijët e familjeve me të ardhura të pakta, të zonave të thella malore, për vajzat në zonat me mentalitet të prapambetur dhe me probleme të tjera sociale.

A**rsimi i mesëm**, aktualisht, ofrohet si *arsim i mesëm i përgjithshëm* (gjimnaz), *arsim profesional* dhe *arsim i orientuar (artistik, sportiv etj.)*.

Arsimi i mesëm ofrohet: a) me kohë të plotë; b) me kohë të pjesshme; c) në distancë.

Forma e arsimimit në distancë ende nuk ka gjetur zbatim. Frekuentimi i arsimit të mesëm të orientuar kufizohet nga kritere preference dhe kryesisht merite. Arsimi i mesëm me kohë të plotë është i hapur për t’u frekuentuar nga të gjithë nxënësit që përfundojnë arsimin bazë, me moshë jo më të madhe se 18 vjeç. Forma alternative e arsimimit (me kohë të pjesshme), për këtë nivel arsimor, është e hapur.

Vihet re rritje e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm vitet e fundit. Për vitin shkollor 2008-2009 tërheqja e nxënësve në arsimin e mesëm është rritur në 80% të nxënësve që mbaruan

arsimin e detyruar, ndërsa në vitin shkollor 2013-2014 ky tregues arriti vlerën 93%(7). Megjithatë, përqindja e thithjes nga arsimi bazë mund të konsiderohet e ulët, e krahasuar me standardet evropiane (95 – 100%). Nga ana tjetër, gjimnazet vijojnë të paraqesin probleme infrastrukture, duke filluar me mbipopullimin e klasave në qytetet e mëdha apo me numrin e paktë të nxënësve në zonat rurale, gjë që rrit shpenzimet për nxënës në to.

Alternativë e arsimit publik paraqitet **arsimi privat.** Që nga viti 1995, kur u lejua hapja e shkollave private, ato janë zgjeruar me një ritëm të moderuar, duke arritur që, në vitin shkollor 2014, të përfshijnë 40509 nxënës ose 6.9% të fëmijëve në arsimin parauniversitar. Në vend funksionojnë 2272 institucione që ofrojnë arsim privat dhe në to janë të punësuar 3750 mësues. Në tabelën 1, paraqiten të dhëna statistikore për vitin shkollor 2014-2015.

**Tabela 1. Të dhëna sasiore rreth APU-së**

**Arsim publik & privat**

| | Gjithsej në APU | APSh | Përqindja Nx. APSh | Arsimi Bazë | Përqindja Nx. AB | Arsimi i Mesëm | Përqindja Nx. AM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Nxënësve | 585945 | 82494 | 14.08% | 363408 | 62.02% | 140043 | 23.90% |
| Nr. Institucioneve | 3569 | 1857 | 48.88% | 1493 | 39.30% | 497 | 13.08% |
| Nr. i Mësuesve | 38380 | 4495 | 11.85% | 24777 | 65.30% | 8671 | 22.85% |

**Arsim publik**

| | Gjithsej në APU | APSh | Përqindja Nx. APSh | Arsimi Bazë | Përqindja Nx. AB | Arsimi i Mesëm | Përqindja Nx. AM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Nxënësve | 545436 | 77154 | 14.15% | 342765 | 62.84% | 125517 | 23.01% |
| Nr. Institucioneve | 3297 | 1751 | 50.62% | 1372 | 39.66% | 381 | 11.01% |
| Nr. i Mësuesve | 34630 | 4150 | 12.14% | 22905 | 66.99% | 7138 | 20.88% |

**Arsim privat**

| | Gjithsej në APU | APSh | Përqindja Nx. APSh | Arsimi Bazë | Përqindja Nx. AB | Arsimi i Mesëm | Përqindja Nx. AM |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i Nxënësve | 40509 | 5340 | 13.18% | 20643 | 50.96% | 14526 | 35.86% |
| Nr. Institucioneve | 272 | 106 | 31.18% | 121 | 35.59% | 116 | 34.12% |
| Nr. i Mësuesve | 3750 | 345 | 9.20% | 1872 | 49.92% | 1533 | 40.88% |

**Nxënës sipas llojit të shkollave të mesme**

| | KLASAT | | | | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| | X | XI | XII | XIII | |
| Gjimnazi (me kohë të plotë) | 36209 | 35405 | 35103 | 0 | **106717** |
| Gjimnazi (me kohë të shkurtuar) | 1364 | 1238 | 1172 | 2284 | **6058** |

Formalisht, organizimi, llojet dhe format e APU-së janë të krahasueshme me standardet europiane. Problem mbeten cilësia, efiçenca dhe efektiviteti (i brendshëm dhe i jashtëm) i sistemit.

(7) Burimi: *Zyra e Statistikave në MAS.*

Ndërkohë, integrimet në kuadër të nismave të ndryshme dypalëshe e shumëpalëshe për bashkëpunim në rajon e më gjerë, po ndryshojnë me shpejtësi kontekstin e organizimit dhe të funksionimit të IA-ve, por edhe misionin e SAPU-së në promovimin e vlerave evropiane, të bashkëpunimit, të tolerancës, të kompetencave kyçe dhe të vlerave të tjera të cilat promovohen nga integrimet rajonale dhe ato më të gjera evropiane. Procesi i integrimit në BE dhe marrëveshjet e arritura për anëtarësim janë tregues të qartë edhe për institucionet tona, për angazhim të përshpejtuar në drejtim të plotësimit të standardeve dhe të përshtatjes ndaj kërkesave paraprake për anëtarësim. Edhe pse arsimi ynë nuk paraqitet në kuadrin e kushteve formale për anëtarësim në BE, sërish, për t'u integruar, konventat e ndryshme në fushën e arsimit paraqiten si standarde të domosdoshme.

# PARAQITJE E KONTEKSTIT TË PËRPARËSIVE – SFIDAT PËRPARA

Reformat e ndërmarra në SAPU, gjatë periudhës 2009-2013, edhe pse iu referuan treguesve mesatarë cilësorë dhe sasiorë të vendeve të BE-së, nuk mundën t'i arrinin këta tregues. Në kontekstin e përgjithshëm, "numri mesatar i viteve të shkollimit të fëmijëve shqiptarë është dukshëm nën mesataren e BE-së, niveli i regjistrimit në arsimin dytësor është gjithashtu i ulët, shkollat janë të tej mbushura dhe cilësia e tyre është shqetësuese. Në Sondazhin e vitit 2009 mbi Klimën e Investimit (ICS), 51% e firmave të mëdha, 41% e eksportuesve dhe 48% e firmave të huaja raportuan aftësitë si një prej pengesave kryesore. Mbi 35% e firmave që futën teknologji të reja kanë përmendur arsimimin e forcës punëtore si një prej pengesave kryesore"[(8)].

### *KAPACITETET DREJTUESE DHE MENAXHUESE TË BURIMEVE TË SAPU-së*

Organizimi dhe funksionimi i IA-ve, në të gjitha nivelet arsimore, dhe përgjegjësitë / kompetencat e tyre rregullohen me ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".

Ndërkaq, kërkimi dhe analiza e gjendjes provojnë cilësi të pakënaqshme të shërbimeve arsimore. Kjo gjendje lidhet me mungesën e institucioneve dhe të programeve të qëndrueshme për aftësimin e administratës arsimore, me mungesën e ofruesve të kualifikuar të shërbimeve trajnuese për drejtuesit arsimorë, me ndërgjegjësimin e pamjaftueshëm të komuniteteve, me mungesën e informacionit dhe të analizave për nevoja si dhe me udhëheqjen e centralizuar dhe të bazuar në urdhër të sistemit. Ndikimi i faktorëve të tillë ka shkaktuar vështirësi në udhëheqjen dhe në menaxhimin e IA-ve, politizim të shpeshtë të arsimit, kufizim të autonomisë së shkollës, udhëheqje rutinë të institucioneve arsimore, përfshirje të pamjaftueshme të komunitetit në çështjet e shkollës, deformime të konsiderueshme në punësimin e personelit, mosshfrytëzimin e duhur të burimeve njerëzore, mungesën e monitorimit, të vlerësimit dhe të inspektimit, si dhe mungesën e të dhënave

(8) Banka Botërore – Shqipëria (2013). *Një vështrim i programit të partneritetit.*

të besueshme për sistemin e arsimit. Të gjitha këto, duket të jenë arsyet kryesore për cilësi të pakënaqshme të udhëheqjes dhe të menaxhimit të SAPU-së.

Ritmet e decentralizimit të përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror drejt atij vendor në SAPU-në nuk kanë qenë të kënaqshme. Kjo ka sjellë pjesëmarrje dhe përgjegjësisë jo të kënaqshme të aktorëve. Pasojat ndihen në menaxhimin e shkollës, në vendimmarrjet në fushën e kurrikulës, në planifikimin dhe menaxhimin e financave, në mirëmbajtjen e shkollës, në menaxhimin e personelit për të ofruar arsim cilësor dhe në funksionin integrues të shkollës.
Mangësi vihen re në konceptimin e përmbajtjes së mbikëqyrjes. Në vend të rolit të mbështetësve të zhvillimit të shkollës, inspektorë, shpesh, mbeten në nivelin e vëzhguesit të jashtëm të procedurave ligjore, të standardeve, të përmbajtjes së metodave mësimore dhe administrative.

Edhe planifikimi dhe menaxhimi arsimor, në nivelet e njësive arsimore vendore dhe të IA-ve, nuk bazohet në monitorimin dhe në vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm, në vlerësimin real të nxënësve, në analizat e planeve të zhvillimit etj. Gjithashtu, baza jo e plotë dhe korrekte e të dhënave pengon hartimin dhe zhvillimin e politikave në sistemit arsimor. Analiza e politikave dhe planifikimi strategjik kërkojnë me urgjencë ngritjen e një sistemi të përparuar të menaxhimit të informacionit arsimor dhe funksionimin efektiv të tij.

SAPU-ja publike financohet nga Buxheti i Shtetit, nga të ardhurat e njësive bazë të qeverisjes vendore, nga dhurimet e sponsorizimet, nga të ardhurat e përftuara nga institucionet arsimore si dhe të ardhura të tjera të parashikuara me ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (neni 37).

Në kontekstin e legjislacionit në fuqi, financimi nga Buxheti i Shtetit planifikohet me formulën "*për nxënës*", sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve infrastrukturore (godina, ndërtim / riaftësim, mirëmbajtje, ruajtje, sigurim dhe garantim i funksionimit të shërbimit arsimor, si ujë, elektricitet etj.) për të gjithë nxënësit në IA-të publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërtimi ose rikonstruksioni i godinave të IA-ve publike financohet me fonde të Buxhetit të Shtetit të miratuara për Ministrinë, ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar, ose me të ardhurat e veta të NJBQV-ve. Ndërsa fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjediseve / godinave të SAPU-së janë të përfshira në burimet e veta të NjBQV-ve. Çdo bashki dhe komunë vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e zotëruara në buxhetin e saj. Ministria përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për mjediset e APU-së.

Shpenzimet për blerjen e mjeteve didaktike dhe shërbimet përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe

realizohen nga njësitë arsimore vendore. Për blerjen e pajisjeve, mjeteve dhe shërbimeve të tjera nuk ka rregull të përhershëm se cili institucion është përgjegjës për prokurimin e tyre. Ato përcaktohen me VKM, çdo vit, si rregulla të prokurimit publik, sikundër pajisja e shkollave me mjete didaktike dhe me libra për bibliotekat e shkollave.

Shpenzimet për transportin e mësuesve, që punojnë jashtë qendrave urbane, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në distancën mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet për transportin e nxënësve që ndjekin arsimin bazë larg vendbanimit, në distancën mbi 2 km, përballohen nga fondet publike. Përfitojnë shpenzime nga fondet publike rreth 8-10% e nxënësve të arsimit 9-vjeçar dhe rreth 35% e mësuesve të SAPU-së.

Janë dhënë falas tekstet për nxënësit romë, për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare, për fëmijët shqiptarë emigrantë, për nxënësit nga familjet me ndihmë sociale dhe për ata që kanë statusin e të verbërve. Çmimi i blerjes së tyre mbulohet tërësisht nga buxheti i Ministrisë.

Bursat dhe mbështetja financiare për nxënësit nga shtresat sociale në nevojë apo me rezultate në mësime miratohen çdo vit me VKM. Nxënësit që ndjekin studimet në IA-të publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera të parashikuara në këtë vendim; shpenzimet për kuotën ushqimore / bursa mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë. Bursat për çdo nxënës përfitues miratohen nga këshillat e NjBQV-ve dhe nga institucionet e arsimit të lartë, duke u dhënë përparësi nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre nga shtresat në nevojë, si dhe administrohen nga NjBQV-të dhe nga institucionet e arsimit të lartë publik. Bursat akordohen mbështetur në kritere ekonomike (të ardhura të ulëta të familjes) dhe në rezultatet e larta në mësime. Me qëllim nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë, me VKM përfitojnë trajtim, bursa studimi, shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe mbulimin e kostos së teksteve mësimore një numër i madh nxënësish e studentësh romë e egjiptianë.

Rimbursimi i çmimit të teksteve shkollore realizohet në mbështetje të VKM-së nr. 107, datë 10.02.2010 "*Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar*".

Financimet publike në arsim janë të qëndrueshme (sipas parashikimeve afatmesme 2015-2020) dhe synojnë rritjen e raportit të financimeve publike në arsim ndaj PBB-së në nivelet e vendeve të tjera të rajonit dhe BE-së. Të dhëna për buxhetet për periudhën 2009-2015 paraqiten në tabelën 2.

Vlerësimi i shpenzimeve private në arsim, që nënkupton investimet e çdo individi në shkollim, apo investimet private në sektorin e arsimit, është i vështirë për t'u gjeneruar dhe për t'u matur. Banka Botërore dhe INSTAT (nëpërmjet pyetësorit të matjes së Nivelit të Jetesës - LSMS 2005) kanë vlerësuar shpenzimet private (individë dhe familje) në arsimim në 0.7% të PBB-së.

Kujdesi i shtuar i familjes shqiptare për arsimin në tërësi dhe në prioritet për arsimin e lartë ka shtuar shpenzimet që janë vlerësuar në 0.8-0.9% të PBB-së.

**Tabelë 2. Të dhëna për buxhetet për periudhën 2009-2013 dhe plani për vitet 2014-2015**

| | PBB (milionë lekë) | Shpenzimet publike (milionë lekë) | Totali i financimit publik në arsim (në milionë lekë) | Raporti i financimeve në arsim me shpenzimet publike | Raporti i financimeve në arsim me PBB | Shpenzimet private /individuale /familjare për arsimin ndaj GDP publike | Shpenzime TOTAL ndaj PBB |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Fakt 2009** | 1,148,082 | 379,863 | 39,256 | 10.3% | 3.42% | 0.8% | 4.22% |
| **Fakti 2010** | 1,222,462 | 362,752 | 42,107 | 11.6% | 3.44% | 0.8% | 4.24% |
| **Fakti 2011** | 1,301,750 | 376,300 | 42,331 | 11.2% | 3.25% | 0.8% | 4.05% |
| **Fakt 2012** | 1,326,160 | 376,241 | 42,749 | 11.3% | 3.2% | 0.9% | 4.1% |
| **Fakt 2013** | 1,358,000 | 409,594 | 42,491 | 10.4% | 3.13% | 0.9% | 4.03% |
| **Plan 2014** | 1,418,000 | 456,403 | 44,262 | 9.8% | 3.17% | 0.9% | 4.07% |
| **Plan 2015** | 1,492,070 | 474,996 | 44,629 | 9.5% | 3.10% | 0.9% | 4.0% |

Aktualisht, financimi i SAPU-së shënjohet nga:

- Niveli jo i kënaqshëm i financimit të arsimit parauniversitar, kundrejt objektivave të miratuar në programin e Qeverisë, për të realizuar funksionet e përcaktuara me ligj.
- Kapacitetet e munguara për menaxhim financiar në nivelet e njësisë arsimore vendore / njësisë bazë të qeverisjes vendore/institucionit arsimor.
- Mos përcaktimi i transfertës së pakushtëzuar që përfitojnë NjBQV-të në ligjin vjetor të buxhetit, që përdorimi i fondeve për arsimin të realizohet sipas formulës “fonde për nxënës”.
- Kujdes i pamjaftueshëm nga NjBQV për të realizuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar, sipas nenit 28 të ligjit nr. 69/2012.
- Reagimi i ngadaltë i sektorit publik për të mbështetur me investime shtimin e godinave dhe të mjediseve shkollore. Migrimi nga fshati në qytet ka bërë që shkollat në qytete dhe në zonat periferike urbane të punojnë mbi kapacitetin e tyre.
- Cilësia e projekteve për ndërtime dhe rikonstruksione të objekteve arsimore (ndërtimet e reja dhe rehabilitimet janë në pronësi dhe në administrim të plotë të NjBQV-ve dhe, në disa raste, janë bërë edhe kur studimet parashikonin që këto shkolla të bashkohen me shkolla të tjera).
- Mos shoqërimi i investimeve të realizuara në arsim (që janë fokusuar kryesisht në ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore- ndërtime të reja dhe rehabilitime) edhe me mjetet didaktike, laboratorë informatike etj., të nevojshme
- Mungesa e autonomisë ligjore reale së institucioneve arsimore për realizimin / arkëtimin e të ardhurave të siguruara nga prindërit, biznesi, si dhe donatorët e ligjshëm për plotësimin e nevojave të tyre, menaxhimin/mbartjen e fondeve, si dhe transferimin nga viti pasardhës.
- Mos çelja e llogarive bankare për çdo shkollë, për të siguruar menaxhim autonom të buxhetit

për mallra dhe shërbime arsimore, për përcaktimin e buxheteve shkollore sipas formulës për planifikimin e buxhetit shkollor, që të përputhet me sistemin e buxhetimit të MF-së.

- Infrastruktura e dobët e sistemit rrugor dhe e transportit që nuk mundëson përqendrimin e shkollave, duke rënduar koston e shërbimit arsimor; në disa zona rurale raporti nxënës/mësues është shumë i ulët, një punonjës mësimor për 10 nxënës.

Në këtë kontekst, financimi dhe mënyra e menaxhimit të fondeve në SAPU duhen përmirësuar thelbësisht, në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe të efikasitetit të shërbimeve arsimore.

### ❖ *CILËSIA E ARRITJEVE DHE NIVELI I KUSHTEVE TË NXËNIES*

Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos, kur kjo lidhet me pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës. Në vijim, paraqiten rezultatet në tre provimin e Maturës shtetërorë dhe në dy Provimet e lirimit (kl. IX)(9).







(9) Burimi: Raporti për rezultatet e Maturës shtetërore – AKP, 2014

Edhe niveli i arritjeve te nxënësve në klasat ndërmjetëse mundet të jetë më i mirë. Në diagramin vijues paraqiten rezultatet e testimit të parë kombëtar (gjuhë shqipe, matematikë, shkencë), në vitin e kaluar shkollor, me dy kampione nxënësish të klasave III dhe V[10].







Prej kohësh, **kurrikula e APU-së** dhe **procesi i nxënies** kanë qenë dhe mbeten objekt përmirësimesh, por edhe kritikash të vazhdueshme. Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme të kurrikulës së arsimit parauniversitar tregojnë se, në ndryshim nga prirjet e sotme të politikave kurrikulare për zhvillimin e qasjes me bazë kompetencat, kurrikula aktuale bazohet kryesisht në qasjen me bazë objektivat[(11)]. Ajo është e organizuar në programe të veçanta, të cilat strukturohen më vete, të palidhura me njëra tjetrën, që vendosin theksin kryesisht te formimi teorik i nxënësve.

Shqipëria merr pjesë në vlerësimin ndërkombëtar PISA. “Pavarësisht tendencës në rritje, performanca e përgjithshme e Shqipërisë mbetet e ulët. Rezultatet PVNN 2012 të Shqipërisë janë më të ulëtat në gjithë Europën dhe Azinë Qendrore (EAQ) dhe ndër më të ulëtat nga të gjitha shtetet

10) Po aty.

(11) Shihni: a) A. Crisan, (2010). *Raporti i konsulencës ndërkombëtare për vlerësimin e kurrikulës së arsimit bazë*. b) IZHA, (2014). *Korniza kurrikulare e Republikës së Shqipërisë.*

pjesëmarrëse në PVNN. Në përgjithësi, Shqipëria është rreth një vit shkollor mbrapa vendeve si Bullgaria, Rumania dhe Serbia dhe rreth dy vjet e gjysëm shkollorë (rreth100 pikë PVNN) pas mesatares së OECD-së”[12]. Vlerësimet e edicionit të vitit 2012 treguan se formimi gjuhësor, matematikor dhe shkencor i nxënësve është dukshëm nën nivelin mesatar të formimit të nxënësve të vendeve të tjera. (Tabela 3).

**Tabela 3. Performanca në aspektin e komunikimit, atë matematik dhe shkencor[13]**

| Performanca sipas aspekteve | Arritja maksimale e vendeve të OECD-së | Arritja mesatare e vendeve të OECD-së | Arritja e nxënësve shqiptarë |
|---|---|---|---|
| **Performanca në lexim** | 613 | 494 | 394 |
| **Performanca në matematikë** | 570 | 496 | 394 |
| **Performanca në shkencë** | 501 | 501 | 397 |

Krahasuar me treguesit e ngarkesës për vendet e OECD-së, ngarkesa informuese e nxënësve tanë është shumë e lartë, sikundër nuk arrihet sa e si duhet nxitja e vetëveprimit të nxënësve në procesin e të nxënit. Kjo vjen nga raporti jo i drejtë mes ngarkesës mësimore dhe kohës mësimore në IA në dispozicion të nxënësve, çka mundet të konstatohet edhe nga të dhënat në tabelën 4.

**Tabela 4. Koha e të nxënit në IA në vende të ndryshme[14]**

**Mesatarja e viteve të shkollimit (kl I - XII)**

| Shqipëria | Europa | Maqedonia | Kroacia | Sllovenia |
|---|---|---|---|---|
| 11.9 | **13.4** | **12** | **12** | **12.2** |

**Orët mësimore gjatë arsimit të detyruar**

| Shqipëria | OECD | Italia | Sllovenia | Greqia |
|---|---|---|---|---|
| 5827 | 7475 | 7400 | 6300 | 7000 |

**Numri i orëve mësimore në vit - Mosha 15 vjeç**

| Shqipëria | OECD | Maqedonia | Kroacia | Sllovenia |
|---|---|---|---|---|
| 761 | 900 | 800 | 610 | 820 |

**Numri i ditëve të nxënies gjatë vitit shkollor**

| Shqipëria | Europa | Maqedonia | Kroacia | Sllovenia |
|---|---|---|---|---|
| 175 | 185 | 185 | 183 | 185 |

(12) Banka Botërore, (2014). *Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri*.
(13) Burimi: http://www.oecd.org/pisa/keyfindings/PISA-2012-results-snapshot-Volume-I-ENG.pdf
(14) Burimi: *Education at a Glance 2014 - OECD indicators*
[http://www.oecd.org/edu/Education-at-a-Glance-2014.pdf]

Reforma kurrikulare e arsimit të mesëm të lartë, e ndërmarrë në vitin 2010, dhe ajo e arsimit bazë, e realizuar në vitin 2013, nuk arritën të zhvillojnë një kurrikul bashkëkohore me bazë kompetencat, ashtu siç po zbatohet ajo aktualisht në vendet e BE-së e më gjerë, pasi ato nuk arritën të zhvillojnë një kurrikul të re me bazë kompetencat.

Kurrikula e **arsimit parashkollor** është hartuar për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Zhvillimi i saj nuk është mbështetur në ndonjë kornizë kurrikulare të hartuar posaçërisht për të ose si pjesë e Kornizës Kurrikulare të arsimit parauniversitar. Ajo orientohet nga standardet e përmbajtjes dhe standardet e arritjes dhe nuk ka koherencë dhe vijueshmëri konceptimi dhe zbatimi. Mungojnë tërësisht instrumentet vlerësuese të cilësisë në APSh. Në këtë aspekt, "janë zhvilluar standarde për të nxënët e hershëm ndërkohë që po zhvillohet një kuadër i ri për zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Procesi i inspektimit për mjediset e zhvillimit të hershëm të fëmijëve po i nënshtrohet reformës. Për qeverinë do të ishte e dobishme që të siguronte një proces të harmonizuar inspektimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet e cilësisë"[(15)].

Kurrikula e **arsimit bazë** i referohet teorisë bihejvioriste të njohjes. Ajo është konceptuar dhe shtjellohet sipas orientimeve të pedagogjisë me objektiva. Kurrikula është e strukturuar në kurrikulën bërthamë dhe atë me zgjedhje (kurrikula në bazë shkolle) dhe është e organizuar sipas lëndëve. Ka, por jo në mënyrë të mjaftueshme, elemente të integrimit ndërlëndor (dituria e natyrës, vendlindja). Ndonëse pretendohet se është hartuar mbi bazën e standardeve të përmbajtjes dhe të arritjeve, në fakt këto standarde janë zhvilluar dhe u miratuan në vitet 2002-2004 për të gjitha lëndët e arsimit 8-vjeçar dhe nuk janë përditësuar për sistemin 9-vjeçar. Shkolla harton dhe menaxhon kurrikulën me zgjedhje, që zë rreth 15% të kurrikulës shkollore, duke u bazuar në interesat dhe prirjet e nxënësve si dhe në mundësitë e vetë shkollës.

Qasja kurrikulare e **arsimit të mesëm** është hibride. Ajo u referohet teorive bihejvioriste dhe konstruktiviste. Kurrikula është e organizuar në kurrikul bërthamë dhe në kurrikul me zgjedhje. Kurrikula bërthamë është e detyruar dhe e njëjtë për të gjithë nxënësit. Kurrikula me zgjedhje zë 19% të kurrikulës së gjimnazit dhe përbëhet nga: kurrikula me zgjedhje të detyruar (11%) dhe kurrikula me zgjedhje të lirë (8%). Në kurrikulën me zgjedhje të lirë, përgjatë 3 viteve të gjimnazit, nxënësit janë të detyruar të zhvillojnë orët e planifikuara për shërbimet komunitare, projekte kurrikulare, module lëndore/ profesionale si dhe për përforcim. Plani mësimor i kurrikulës bërthamë është i ngarkuar. Pesha e vlerësimit të lëndëve në kurrikulën bërthamë dhe me zgjedhje dallon lëndët dhe dënon vetë zgjedhjen. Mundësitë e ndryshme të zbatimit nga shkolla krijojnë pabarazi në zgjedhje. Mënyra e organizimit dhe e strukturimit të kurrikulës krijon probleme në menaxhimin e saj nga shkolla. Për elementë të veçantë të kurrikulës, mungon koherenca ndërmjet konceptimit dhe zbatimit të tyre, si p.sh., ndërrimi i lëndëve me zgjedhje brenda shkollës dhe nga një shkollë në tjetrën, projektet kurrikulare, modulet profesionale. Plani mësimor aktual rezulton një nga më të

(15) Banka Botërore, (2014). *Zhvillimi në fëmijërinë e hershme*. *Shqipëria.*

ngarkuarit në Europë(16). Programet e bazuara në planin mësimor aktual janë të mbingarkuar, për shkak të ngarkesës konceptuese jo në përputhje me zhvillimin e nxënësve dhe të mungesës së koherencës midis lëndëve. Edhe pse është skicuar një format i përgjithshëm, struktura e programeve lëndore nuk është gjithmonë uniforme dhe paraqitet me ndryshime nga lënda në lëndë, nga klasa/vit në klasë/vit. Rubrika të veçanta në programe të veçanta nuk janë të përdorshme nga përdoruesit. Theksi mbi lëndët ka cenuar koherencën e kurrikulës. Mungon një qasje e diferencuar, që të ofrojë mundësi të barabarta për gjithë nxënësit. Si pasojë e këtyre dobësive, kurrikula e SAPU-së nuk përmbush nevojat dhe interesat e vërteta të nxënësve, ato të prindërve dhe të shkollës.
Joefikase ka rezultuar **politika e Altertekstit**(17).

Rezultatet e ulëta në vlerësimin e nxënësve tregojnë se ata nxënë më shumë fakte; të mësuarit është kryesisht verbal; mungojnë aftësi të tilla si të menduarit kritik, të menaxhimit të informacionit nga burime të larmishme, të punës në grupe të vogla nxënësish që formojnë synimet themelore të kurrikulave të vendeve të zhvilluara. Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare si, p.sh., PISA, që ka si synim kryesor vlerësimin e kompetencave, dëshmojnë të njëjtin fakt.

Cilësia e arritjeve të nxënësve tanë është ndikuar edhe nga **mos identifikimi i të gjithë fëmijëve të moshës shkollore** që nuk janë të regjistruar në sistemin arsimor(18), por edhe për sigurimin e të drejtës së nxënësve për t'u përfshirë në të gjitha nivelet e arsimimit dhe të trajnimit, pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë, përmes rritjes së përqindjes së regjistrimit në nivelin e dytë, sidomos të fëmijëve të zonave rurale, në veçanti të vajzave. Sigurimi i kësaj të drejte përmbush edhe një përparësi në kuadër të Objektivave Zhvillimorë të Mijëvjeçarit të OKB-së dhe të Partneritetit Europian.

Edhe **shtrirja** dhe **funksionimi i shërbimit psiko-social** nuk janë të qarta. Shërbimi ose nuk është ngritur, ose është ngritur në kundërshtim me Urdhrin Nr. 344, datë 19.08.2013 të Ministrit. Nuk mbulohen me specialistë të gjitha IA-të, për shkak të vështirësive infrastrukturore apo të pozicionit gjeografik të shkollave.

Me gjithë investimet e bëra, **përdorimi i TIK-ut,** në funksion të përmirësimit të cilësisë së arritjeve dhe të menaxhimit të burimeve, është i kufizuar. Kështu:

- Sot në SAPU kemi 1496 laboratorë kompjuterësh. Rrjeti i internetit është instaluar në shkolla dhe 1096 shkolla kanë lidhje të dedikuar broadband në mjediset e laboratorëve kompjuterike me

(16) A. Crisan (2010). *Raporti i konsulencës ndërkombëtare për vlerësimin e kurrikulës së arsimit bazë*.

(17) MAS-i, këtë vit, në mirëkuptim me shtëpitë botuese, hoqi nga qarkullimi 120 tekste shkollore për dobësi me natyrë shkencore dhe pedagogjike.

(18) Shihni Urdhrin e përbashkët Nr. 2, datë 05.01.2015 *"Për miratimin e Rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit datë 02.08.2013 "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor"" (MAS - MPB - MSh).*

shërbim të ofruar në parametrat 2-10Mb/sec. Ndërkohë, 794 shkolla furnizohen nga PAP me një shpejtësi 8Mb/sec.

- Raporti kompjuterë për nxënës është 1:35 ose më keq.
- Nxënësit mund të marrin informacion vetëm në laboratorët kompjuterikë; në më shumë se 1/3 e shkollave, nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e informacionit online.
- Mungojnë përmbajtjet digjitale në gjuhën amtare; shfrytëzohen vetëm përmbajtje nga interneti, që dallojnë nga burimi i shfrytëzuar; është shfaqur rreziku i ekspozimit përballë përmbajtjeve të papërshtatshme.
- Nga shkollat e arsimit bazë publik, raportohen 15731 PC, nga të cilët 11331 janë funksionalë, ndërsa 4400 PC janë jofunksionalë. Shkollat raportojnë 1631 laptopë, nga të cilët 432 janë jashtë funksionit.
- Përdorimi i SMAI-s nuk funksionon si bazë për hartimin politikave në të gjitha nivelet. Për këtë arsye, zhvillimi i plotë i tij mbetet një nga përparësitë e reformës.
- Moduli GIS (Geographical Information System) & SIMS (TA-ALB-10) përfaqëson një sistem të pa përditësuar me të dhënat aktuale dhe nuk është i mirëmbajtur.
- Moduli Financiar që menaxhon financat dhe buxhetin e IA-ve në nivel qendror dhe lokal funksionon vetëm pjesërisht në disa DAR-e.
- Investimet në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore për t’i përdorur këto sisteme ka qenë tepër i reduktuar, çka ka sjellë përdorimin e reduktuar.

Shkak tjetër i uljes së cilësisë së arritjeve është dhe **mbipopullimi i klasave** në zonat e periferive të qyteteve kryesore, si rezultat i migrimit të brendshëm. Reagimi i ngadaltë i sektorit publik ndaj migrimit nga fshati në qytet ka bërë që shkollat në qytete dhe në zonat periferike urbane të punojnë mbi kapacitetin e tyre. Në të kundërt, në disa zona rurale raporti nxënës/mësues është shumë i ulët. Ndërkaq, infrastruktura e dobët e transportit nuk mundëson përqendrimin e shkollave ndërsa ofrimi i shërbimit të transportit shpesh herë nuk i plotëson nevojat e nxënësve dhe bëhet faktorë për braktisjen e shkollës

Në mjaft raste**, gjendja e objekteve dhe e terreneve sportive** (të hapura dhe të mbyllura) ka ndikuar në mos realizmin e veprimtarive kurrikulare në shkolla.

### *SIGURIMI I CILËSISË SË ARRITJEVE*

Në këtë dokument, termi “sigurimi i cilësisë së arritjeve” u referohet vlerësimit, inspektimit dhe auditimit, funksione këto që realizohen përmes vetëvlerësimeve dhe vlerësimeve të jashtme. Vetëvlerësimi realizohet nga institucioni arsimor, ndërsa vlerësimet e jashtme të cilësisë realizohen nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë shpreh efektivitetin e proceseve që zhvillohen në institucion dhe

masën e përputhjes së treguesve të pranuar të cilësisë me produktet dhe arritjet. Ai është rezultat i matjes/monitorimit të ecurisë së procesit ose produktit të tij. Me përpjekjet e bëra nga Ministria dhe organizatat profesionale (si p.sh., "Save the Children") janë përgatitur manualet "Inspektimi i plotë i shkollës" e "Vetëvlerësimi i shkollës" dhe materiale të tjera që ndihmojnë procesin. Megjithatë, vetëvlerësimi, ende, nuk ka arritur të integrohet me sistemin e menaxhimit të përditshëm të institucioneve arsimore. Në rastin më të mirë, procesi është veprimtari që kryhet vetëm një herë në vit, por, sërish, mungojnë analiza dhe vlerësimi profesional i gjetjeve. "Sipas OECD-së, Shqipëria është i vetmi vend, të dhënat për familjet e të cilit për PVNN 2012 nuk janë të besueshme. ... është kritike që të ketë mekanizma për të siguruar cilësinë e mbledhjes së të dhënave në mënyrë që politikat të mbështeten në prova" [(19)].

IShA është institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Misioni i tij është përmirësimi i cilësisë së arritjeve në AP dhe zbatimi i kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Pavarësisht nga përpjekjet e bëra deri tani për reformimin e mënyrës së inspektimit në SAPU-së dhe Arsimin e Lartë si dhe nga arritjet e deritanishme, vihet re se ka vend për përmirësim në këtë drejtim. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për inspektimin në drejtim të vlerësimit të cilësisë së elementeve të përmbajtjes së nxënies, të metodave mësimore apo të procedurave administrative. Mënyra e organizimit të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, duke e konceptuar inspektimin vetëm si funksion të nivelit qendror, nuk është i mjaftueshëm. IShA, aktualisht, realizon 25-30 inspektime të plota në një vit shkollor, ndaj nuk mund të ndikojë sa e si duhet në sigurimin e cilësisë së sistemit. Raporti aktual është 27 inspektorë për rreth 4.000 IA (nga të cilat, afro 1800 janë në arsimin parashkollor) që duhen inspektuar. Kjo ka bërë që inspektimi të jetë larg standardeve europiane, sipas të cilave çdo shkollë u nënshtrohet inspektimeve të plota të paktën një herë në tre vite. Përgjithësisht, inspektorëve dhe specialistëve të njësive arsimore vendore, që menaxhojnë aspektet kurrikulare, u mungon kompetenca e certifikuar për monitorimin, për vlerësimin e nxënies dhe të arritjeve dhe për ndihmën ndaj mësuesve/drejtuesve.

Ndërsa AKP-ja harton dhe administron vlerësimet dhe provimet kombëtare, për t'u siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ajo harton dy provime kombëtare që priren të jenë të standardizuara: Provimi i Lirimit (PL) dhe Matura Shtetërore (MSh) që zhvillohen në sesionin e qershorit dhe sesionin e vjeshtës. PL-ja konsiderohet i shkallës së ulët, pasi rezultatet e tij nuk kanë ndonjë ndikim të madh në arsimimin e mëtejshëm të nxënësve. MSh-ja konsiderohet provim i shkallës së lartë, pasi rezultatet e saj kanë ndikim të rëndësishëm në arsimimin e mëtejshëm apo në punësimin e nxënësve. Vështirësia e testeve të MSh-së, në përputhje me nivelin e vështirësisë së përcaktuar në rregulloren e MSh-së, ka qenë e natyrës mesatare.

---

(19) Banka Botërore, (2014). *Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri*, (fq. ix).

Aftësitë e vlerësimit, të analizës dhe të interpretimit nuk përputhen si duhet me standardet bashkëkohore dhe provohen kompetenca profesionale jo të mira të hartuesve dhe të zhvilluesve të testeve, qoftë për provimet kombëtare, vlerësimet kombëtare apo procese të testimit paraprak. Stafi i AKP-së nuk ka ekspertizën e nevojshme, lidhur me hartimin e instrumenteve të vlerësimit, me analizën e pyetjeve dhe me interpretimin psikometrik të testeve. Gjithashtu, mungesa e kritereve kombëtare të vlerësimit, të qarta dhe të sakta, ka pështjelluar vlerësimin me notë. Si pasojë, i njëjti nxënës, për të njëjtën sasi njohurish dhe aftësish që demonstron, mund të marrë vlerësime të ndryshme nga mësues të ndryshëm, madje, dhe nga i njëjti mësues në ditë të ndryshme.

Nga ana tjetër, në vendin tonë nuk njihet si duhet testimi shkencor i standardizuar dhe objektiv. Prandaj, shpesh, përdoruesit e produkteve që ofron AKP-ja, e kanë të vështirë t'i kuptojnë ato. Analiza e testeve, e mjediseve, krahasimi i rezultateve të maturës me ato vjetore si dhe dëshmitë e shumta nga praktika tregojnë për një proces të çrregullt, shpesh kaotik.

Në vendin tonë nuk prodhohet raporti vjetor për cilësinë e arritjeve, për vështirësitë dhe për sfidat që ndesh SAPU-ja.

### ❖ *PROBLEMATIKAT E BURIMEVE NJERËZORE*

Përgatitja e mësuesve të rinj nuk po ecën me ritmet e duhura; sfidat për përmirësimin e programeve të reja janë të mëdha dhe nevoja për mësues të rinj të përgatitur mirë është e padiskutueshme. Konstatohet se kurrikulat, shpesh, janë të mbingarkuara dhe nuk tregohet vëmendje se çfarë programe studimi janë të nevojshme për mësuesin e suksesshëm. Nuk zhvillohen sa duhet praktika të mbikëqyrura në mësim, sikundër ndryshojnë shumë nga një FE në tjetrin programet e studimit. Elementet më kritike kanë të bëjnë me përmbajtjet disiplinore, me teoritë e të nxënit, me pedagogjinë, me menaxhimin e klasës etj. Përgatitja e mësuesve në FE-të karakterizohet nga (i) struktura të fragmentuara (programet për përgatitjen e mësuesve ofrohen nga 7 fakultetet) dhe (ii) nivele të ndryshme të cilësisë së përmbajtjes akademike dhe pedagogjike të programeve.

Në Shqipëri, programet Bachelor për mësuesi i ndjekin studentët që nuk kanë shumë zgjedhje. Këtë e tregon numri i pikëve që të lejon të regjistrohesh në FE. E njëjta gjë për programet e Masterit të mësuesisë në UT që përgatit mësues për shkollën e mesme. Numri i kuotave është gjithnjë më i lartë se ai i kërkesave, duke i dhënë mundësi të regjistrohet kujtdo që ka mbaruar nivelin Bachelor, pavarësisht nivelit të përgatitjes shkencore të arritur në këtë nivel. Vihet re një shpërndarje jo e drejtë lëndore e këtyre mësuesve sipas kërkesave të njësive arsimore vendore. Kjo gjendje duhet të ndryshojë përmes nxitjes së maturantëve me rezultate të larta për të ndjekur FE-të.

Konsiderohet hap përpara përcaktimi me ligj i mësuesisë si profesion i rregulluar - zhvillimi i praktikave profesionale, provimet e shtetit, financimi i praktikantëve. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit, çdo kandidat duhet të ketë përfunduar studimet e ciklit të dytë në fushën e

mësuesisë, të ketë kryer praktikën profesionale dhe të rezultojë fitues në Provimin e Shtetit. Në tabelën 5 paraqiten rezultatet në provimin e shtetit të arrira nga mësuesit e diplomuar.

**Tabela 5: Rezultatet sipas profileve në vitet 2013 dhe 2014**

| Nr. | Profesioni | Pjesëmarrës 2013 | % Mbetës | Pjesëmarrës2014 | % Mbetës |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Arsimi Fillor | 8 | 100.00 | 39 | 57.14% |
| 2 | Arte Figurative | 1 | 100.00 | 5 | 40.00% |
| 3 | Biokimi | 21 | 85.71 | 42 | 48.57% |
| 5 | Edukim Fizik | 30 | 40.00 | 66 | 82.35% |
| 6 | Fizik | 5 | 80.00 | 68 | 65.52% |
| 7 | Gjeografi | 13 | 46.15 | 19 | 37.50% |
| 8 | Gjuhë Angleze | 40 | 40.00 | 71 | 32.76% |
| 9 | Gjuhë Frënge | 3 | 66.67 | 156 | 28.93% |
| 10 | Gjuhë Gjermane | 1 | 100.00 | 29 | 36.00% |
| 11 | Gjuhë Italiane | 1 | 100.00 | 13 | 41.67% |
| 12 | Gjuhë-Letërsi | 34 | 26.47 | 37 | 51.72% |
| 13 | Histori | 6 | 50.00 | 155 | 27.69% |
| 14 | Histori-Gjeografi | 11 | 90.91 | 69 | 18.64% |
| 15 | Histori-Gjeografi Edukate | 14 | 78.57 | 52 | 84.21% |
| 16 | Informatikë | 0 | 0 | 31 | 80.00% |
| 17 | Kimi | 3 | 100.00 | 1 | 100.00% |
| 18 | Matematik | 8 | 50.00 | 35 | 15.15% |
| 19 | Matematik-Fizik | 15 | 53.33 | 63 | 29.82% |
| 20 | Matematik-Informatik | 11 | 54.55 | 40 | 68.75% |
| 21 | Shkenca Sociale | 2 | 50.00 | 19 | 15.25% |
| | **Total** | **237** | **52.74%** | **1091** | **47.06%** |

Por, edhe pse rregullimi ligjor i këtij profesioni është i relativisht i krahasueshëm me përvojat e vendeve të tjera, përvoja jonë e deritanishme tregon se ky element përballet me sfida të ndryshme, si pamundësia për t’i përfshirë të gjithë kandidatët në praktikën pedagogjike, dobësi në testimet për licencë, problemi i pagës së praktikantëve dhe mungesa e mentorëve profesionistë. Edhe Rregullorja për zhvillimin e praktikave të profesionit të rregulluar të mësuesisë duket nuk rregullon si duhet marrëdhëniet mes mentorëve dhe praktikantëve. Ajo ngarkon me punë më të madhe mentorin, në vend që ta motivojë atë për të realizuar detyrën.

Sistemi i ZhP-së të personelit në detyrë nuk mundësoi zhvillimin e formave të trajnimit në bazë shkolle dhe / ose online, përcaktuar nga ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Pavarësisht nga përpjekjet e organizuara të institucioneve vendore e ndërkombëtare, sot konstatohen probleme të shumta në fushën e nxënies dhe të ZhP-së së mësuesve dhe të drejtuesve. Në shkolla ka shumë mësues që nuk janë përfshirë në trajnime apo në seanca për

ZhP-në; mungon baza e nevojshme e të dhënave në këtë fushë dhe nuk janë plotësisht funksionale rregulloret për akreditimin e programeve dhe të organizatave që ofrojnë trajnime për ZhP-në të mësuesve; ka vonesa ose dobësi në licencimin e mësuesve. Mbeten problemet me nivelin jo të përshtatshëm të pagave të mësuesve dhe me sistemin e gabuar dhe aspak motivues të kompensimit për punën e kryer. Përfshirja e pamjaftueshme e të gjithë mësuesve në programet e aftësimit, instrumentet e munguara për identifikimin dhe çmuarjen e nevojave për ZhP-në, larmia dhe thellësia e programeve trajnuese janë dobësi të tjera që kërkojnë trajtim urgjent nga ekspertët, në kuadër të zbatimit të strategjisë.

Problemet e konstatuara theksojnë edhe më shumë rëndësinë e të nxënit cilësor gjatë gjithë jetës, për të pasur një sistem efektiv ZhP-je. Për këtë arsye, tani, pas përfundimit të paketës kurrikulare, do të zhvillohen politika, programe dhe projekte që do të zhvendosnin përparësinë nga procesi i përvetësimit të kurrikulës zyrtare, në fushën e aftësimit, të përgatitjes praktike dhe të licencimit periodik të mësuesve. Sipas legjislacionit në fuqi, format e ZhP-së së mësuesve janë trajnimi në shkolla, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata. Në legjislacion theksohet se mësuesit dhe drejtuesit trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe se trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe të ofertave nga agjencitë trajnuese që mund të jenë publike ose private. Ndërkaq, trupa mësimore e një shkolle i ngjan më shumë një bashkësie individësh të izoluar profesionalisht, sesa të një organizate profesionale që mban përgjegjësi të përbashkëta dhe kërkon e gjen bashkërisht rrugëzgjidhje për arritje cilësore të nxënësve të shkollës. Asistenca profesionale ndaj mësuesve, nga ana e drejtuesve të shkollave, është e papërfillshme. Ajo ka zëvendësuar këshillimin profesional me kontrollin dhe rezulton me efektivitet të ulët.

Joefikase ka rezultuar dhe politika e zbatuar nga Ministria për liberalizimin e tregut të shërbimeve trajnuese. Kështu, sot, asnjë nga FE-të nuk siguron kushte për ZhP-në e mësuesve, ndërsa shumë operatorëve privatë që ofruan trajtime, u mungoi ekspertiza profesionale. Edhe programet e ofruara, në pjesën më të madhe, nuk iu përgjigjën si duhet nevojave të përfituesve. Nga ana tjetër, punonjësit arsimorë u përfshinë me vështirësi në veprimtaritë trajnuese për mungesë të informimit rreth programeve të ofruara, por edhe pse pagesat për shërbimet e ofruara ishin të larta. Për arsye si këto, do të rritet niveli i financimit për ZhP-në e mësuesve në shërbim dhe do të ndryshojë mënyra e financimit. Procedurat e reja të financimit do të motivojnë financiarisht FE-të që të ofrojnë trajnime të tilla.

Në kontekstin e përgjithshëm, gjejmë një botë që karakterizohet nga ndryshime të shpejta, nga globalizimi në rritje dhe nga ndërlikimi gjithnjë e më i madh i marrëdhënieve shoqërore, kulturore dhe ekonomike, të udhëhequra nga dija. Konteksti i ndryshimeve të tilla, doemos, duhet të reflektohet në objektivat e ardhshme të planifikimit strategjik në arsimin tonë.

***Ky kontekst i përgjithshëm na ndihmon të identifikojë dhe kuptojmë sfidat që ekzistojnë realisht, kapërcimi i të cilave kërkon politika të reja.***

# 2 SEKSIONI

## VIZIONI DHE QËLLIMI POLITIK

## ❖ VIZIONI[20]

Vizioni i SZhAPU 2014-2020, i frymëzuar nga objektivi i përgjithshëm i "Europa 2020" për realizimin e një rritjeje kombëtare të shpejtë dhe të qëndrueshme, është:

***Sistem arsimor që ka në qendër nxënësin, mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i shërben konsolidimit të shoqërisë demokratike.***

## ❖ QËLLIMI POLITIK

***Strategjia ka si qëllim:***

- ***të ndihmojë, të bashkërendojë, të rregullojë dhe të promovojë arsimin cilësor për të gjithë;***
- ***të orientojë masat afatmesme, planifikimin vjetor, hartimin dhe realizimin e buxhetit;***
- ***të sigurojë bazën për koordinimin dhe negocimin me agjencitë qeveritare, me partnerët dhe me palët e tjera në SAPU, për të përcaktuar zgjerimin dhe për të përdorur investimet dhe planifikimin afatgjatë në një kornize unike të planëzimit dhe të financimit.***

Qëllimi do të përmbushet përmes veprimtarive politike efektive, bashkëpunimit të hallkave të shoqërisë, përputhjes së veprimeve me planifikimin buxhetor dhe me kornizat e tjera të zhvillimit, si dhe përmes monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë.

## ❖ PËRPARËSITË E POLITIKËS[21]

***A. Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të kapaciteteve dhe të burimeve.***

***B. Nxënia gjithëpërfshirëse cilësore.***

***C. Sigurimi i cilësisë i bazuar në standarde që krahasohen me vendet e BE-së.***

***D. Përgatitja dhe zhvillimi profesional bashkëkohor i mësuesve dhe i drejtuesve.***

---

(20) a) "*Nevojiten përmirësime të arsimit në të gjitha nivelet dhe ai duhet të përmbushë kërkesat e tregut të punës*". KE (2013). Progres Raporti 2013 për Shqipërinë.
b) *Pavarësisht përparimit, performanca e ulët e nxënësve në përgjithësi ka gjasa që të ketë ndikim negativ në zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe tek mundësitë për mirëqenie ndër breza*.
Banka botërore, (2014). Cilësia e Arsimit dhe Mundësitë për Zhvillimin e Aftësive në Shqipëri.

(21) *Siç dëshmojnë rezultatet e PISA-s, sistemi arsimor duhet të reformohet, përfshi formimin e mësuesve, masat për sigurimin e cilësisë, transparenca, përvojat praktike të nxënies dhe lidhja me sektorin e biznesit*. (Po aty).

**Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020**

Reforma në SAPU orientohet nga përparësitë e *Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020*, nga standardet e përcaktuara në *Programin e Reformimit të Arsimit Europian 2020*, nga objektivat e nismës *Arsimi për të Gjithë* të UNESCO-s, si dhe nga piketat dhe proceset për zhvillimin e harmonizuar të Evropës.

Këto dokumente dhe procese po formatojnë thelbësisht kontekstin rajonal dhe europian të arsimit. SZhAPU-ja do koordinohet edhe me dokumente të tjera politike të Qeverisë Shqiptare si plani i aksionit për Komunitetet Roma dhe Egjiptiane (sesioni i arsimit ), Politika e Përfshirjes Sociale etj. Është ky kontekst i ri, ai që kërkon doemos strategji, politika dhe qasje të reja të sistemit dhe të komunitetit tonë arsimor. Të gjitha këto, së bashku, janë trajtuar nga ekspertë e përfshirë në procesin e hartimit të strategjisë së zhvillimit të APU-së 2014 – 2020.

# 3 SEKSIONI

## OBJEKTIVAT E POLITIKAVE DHE REZULTATET KRYESORE

*Objektivat politikë* dhe *masat / veprimet* përkatëse sipas përparësive, paraqiten në vijim.

| A. PËRSOSJA E QEVERISJES, UDHËHEQJES DHE MENAXHIMIT TË KAPACITETEVE DHE TË BURIMEVE | |
|---|---|
| **Objektiva politikë** | **Veprimtari kryesore** |
| A1. Përmirësimi i legjislacionit. | A1.1 Rishikohet, plotësohet dhe përditësohet baza ligjore. |
| A2. Ristrukturimi institucional në kontekstin e forcimit të autonomisë institucionale. | A2.1 Ndërtohen kapacitetet të reja për qeverisjen, udhëheqjen e menaxhimin. |
| | A2.2 Përcaktohen dhe zbatohen procedurat për vlerësimin dhe për vetëvlerësimin e udhëheqjes dhe të qeverisjes. |
| | A2.3 Përmirësohen mekanizmat për hartimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit për institucionet arsimore. |
| | A2.4 Ndërtohet infrastruktura për përpunimin e të dhënave në arsim. |
| | A2.5 Mbarten kompetenca nga niveli qendror në nivelin bashkiak dhe nga bashkitë te shkollat (decentralizimi). |
| | A2.6 Sigurohen pjesëmarrja dhe transparenca në vendimmarrje. |
| | A2.7 Koordinohen veprimtaritë mes IA dhe sektorëve të tjerë. |
| | A2.8 Rriten fondet për arsim. |
| | A2.9 Rishqyrtohen dhe përmirësohen kriteret për financim. |
| | A2.10 Koordinohen veprimtaritë mes udhëheqjeve arsimore dhe sektorëve të tjerë. |

## REZULTATET KRYESORE

Duke filluar:

1. Nga viti 2015, **mbarten kompetenca** për menaxhimin e burimeve drejt nivelit rajonal dhe shkollave (decentralizimi).
2. Nga viti 2015, përgatiten raporte periodike **vetëvlerësimi** dhe **vlerësimi** të performancës institucionale dhe vetjake, të standardizuara, në të gjitha nivelet e arsimit.
3. Nga viti 2015, zbatohen **plane zhvillimi** efikase në IA-të e të gjitha niveleve arsimore.
4. Nga viti 2016, ekziston **legjislacioni i nevojshëm arsimor**, i krahasueshëm me atë të vendeve të BE-së.
5. Nga viti 2016, ndërtohen **kapacitete të reja** për përgatitjen e drejtuesve dhe të menaxherëve.
6. Nga viti 2016, sigurohet **pjesëmarrja** dhe **transparenca** në procesin e marrjes së vendimeve.
7. Nga viti 2016, vendosen dhe zbatohen **kriteret dhe rregulloret** për financim që ndihmojnë me

përparësi gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim.

8. Nga viti 2016, funksionon modeli efektiv i financimit "**për nxënës**".
9. Nga viti 2017, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor **funksionon SMIA** dhe vendimmarrjet bazohen në të dhëna.
10. Nga viti 2017, vendoset **sistemi i koordinimit** dhe i **ndërveprimit** mes niveleve të ndryshme të drejtimit të arsimit dhe sektorëve të tjerë.
11. Nga viti 2017, zbatohet **legjislacioni i ri** ose **i përditësuar** në IA.
12. Nga viti 2017, janë ndërtuar dhe funksionojnë mekanizmat për **menaxhimin e decentralizuar** të mjeteve financiare.
13. Nga viti 2017, zbatohen mekanizmat për **mbulimin e kostos për tekstet**.
14. Nga viti 2017, **përqindja e PPB** për SAPU-në arrin masën **3%**, ndërsa për sistemin në tërësi 5%.(22)
15. Nga viti 2018, funksionon **sistemi i transparencës** së financimit dhe i politikave për nxitjen dhe tërheqjen e fondeve nga sektori privat.
16. Nga viti 2020, **shpenzimet publike "për nxënës**" janë të krahasueshme me nivelin e mesatares së vendeve të rajonit.

Përmbushja e objektivave politike, të përcaktuara për këtë përparësi strategjike, kërkon ndryshime të mëdha. Hapat për përmirësimin e administrimit të centralizuar të një sistemi të decentralizuar do të përbëjnë hop të rëndësishëm zhvillimi dhe performance edhe për SAPU-në. Ky proces do të ketë për objektiv fundor zhvillimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në të gjitha nivelet e sistemit, bazuar në kërkimin dhe të orientuar nga të dhënat.

Sfida e parë është *funksionimi i sistemit menaxhuese të performancës* në të gjitha nivelet e qeverisjes arsimore. Synohet të arrihet në modelin e menaxhimit mbi bazë performance në të gjitha nivelet dhe të instalohet matja e saj si pjesë e kulturës profesionale. Kjo forcon rritjen e transparencës për rolet e vendeve të punës në të gjithë piramidën administrative dhe qartësimin më të mirë të detyrave, të përgjegjësive e të detyrimeve reciproke institucionale për secilin vend pune. Për pasojë, do të rritet shkalla e performancës së çdo individi të përfshirë në menaxhimin e sistemit, do të sigurohet dhe ruhet niveli minimal i performancës, si dhe do të krijohen përgjegjësi vetjake më të mëdha për vetëzhvillim dhe risi. Sistemi i ri do të sigurojë raportimin dhe auditimin në disa drejtime, përmes mekanizmave të brendshme dhe të jashtme, duke rritur transparencën për veprimtarinë e tij. Brenda vitit 2016, MAS-i do të operojë sipas këtij modelit, për të kaluar më pas në nivelin e mesëm dhe atë të IA-ve.

Me gjithë luhatjet që mund të shoqërojnë procesin, përparimi drejt *autonomisë shkollore* do të jetë i qëndrueshëm. IA-të do të ndihmohen të marrin përgjegjësi më të mëdha në planifikimin, menaxhimin dhe përmirësimin cilësor të shërbimeve që sigurojnë. Aktualisht, strukturat dhe

(22) Në vitin 2010, vendet e OECD shpenzuar mesatarisht 6,3% të PBB-së së tyre në IA. Në këto vende shpenzimet për APU-në janë 3-4 herë më të mëdha se ato për arsimin universitar.
[OECD (2013), *Education at a Glance 2013*: *OECD Indicators*]

personeli ekzistues kanë kapacitete të kufizuara për ta kthyer këtë në realitet. Deri tani, komunitetet lokale dhe prindërit janë përfshirë shumë pak në planifikimin e veprimtarive arsimore dhe në zgjidhjen e problemeve që shoqërojnë procesin e të nxënit, prandaj ata nuk e ndjejnë si duhet përgjegjësinë që kanë për zhvillimin dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve që ofron IA. Përmirësimi i autonomisë shkollore në fushat e kurrikulës, të financimit, të personelit dhe të menaxhimit në nivel shkolle e më lart realizohet efektivisht, duke e kompletuar me bazën përkatëse ligjore dhe ngritjen e organizmave përgjegjëse për zbatim e mbikëqyrje.

Realizimi i autonomisë shkollore përfshin ndryshimin e një pjese të *legjislacionit aktual*. Ky legjislacion nuk nxit dhe nuk mbështet sa dhe si duhet pjesëmarrjen e prindërve apo të drejtuesve të IA-ve për të marrë nisma që lidhen me përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor. Këtij objektivi do t'i shërbejë ngritja dhe funksionimi i shkollës që licencon drejtuesit, të rinj apo në detyrë.

Financimi i arsimit nuk i përgjigjet me efektivitet plotësimit të nevojave. MAS-i duhet të kërkojë mjete alternative financimi të cilat mund të përballohen nga burime të tjera publike dhe private. . "Në një mjedis të kufizuar fiskal, Shqipëria është e detyruar të shpenzojë më pak se mesatarja rajonale për frymë për arsimin. Megjithatë ka ende mundësi për të përmirësuar eficiencën e shpenzimeve për arsimin dhe identifikimin e burimeve shtesë" [23]. Ndërkaq, objektivi qeveritar për rritjen e buxhetit të APU-së në masën 3% të PBB-së, në fund të 2020, kërkon rritjen e shpenzimeve publike për arsimin, në raport me PBB.

Në kontekstin e legjislacionit në fuqi, financimi nga Buxheti i Shtetit planifikohet me formulën "*për nxënës*", sipas treguesve të veçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike. Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve infrastrukturore (godina, ndërtim / riaftësim, mirëmbajtje, ruajtje, sigurim dhe garantim i funksionimit të shërbimit arsimor, si ujë, elektricitet etj.) për të gjithë nxënësit në IA-të publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërtimi ose rikonstruksioni i godinave të IA-ve publike do të financohet me fonde të Buxhetit të Shtetit të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar miratuar për NJBQV, të ardhurat e veta të NJBQV-ve, si dhe nga grante apo kredi të "buta", të siguruara nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Projektet për ndërtimin ose rikonstruksioni i godinave të IA-ve publike, të konsideruar parësore për financim nga MAS-i, do të vijojnë të mbështet me prioritet, duke analizuar treguesit e mëposhtëm:

---

(23) BB (2014). *Dialogu për politikat në reformën arsimore në Shqipëri.* [http://www.worldbank.org/sq/news/press-release/2014/09/17/quality-education-and-market-relevant-skills-critical-for-albania-growth-competitiveness]

1. Numri aktual i nxënësve/fëmijëve/studentëve në objektin ku do kryhet investimi; prioritet kanë shkollat me numër të lartë nxënësish.
2. Shkallën e amortizimit të objekteve ekzistues/nevojat për ndërhyrje emergjente (rrezik shembje, ndërhyrje serioze dhe të menjëhershme, zjarri, përmbytje, tërmet etj.).
3. Nevoja për të ndërhyrë në një objekt shkollor në varësi edhe me kushtet e transportit / infrastrukturës së rajonit ku ndodhet objekti.
4. Politikat e MAS për shpërndarjen gjeografike të shkollave/IAL-ve publike në varësi të lëvizjeve demografike apo racionalizimit të shkollave apo rajonizimit te institucioneve arsimore.
5. Rastet kur mësimi zhvillohet në ambiente të marra me qira;
6. Mbipopullimi i klasave për mungesë të ambienteve të përshtatshme për të zhvilluar mësim apo zhvillim i mësimit me turne.

Faktorë të tjerë me ndikim në vlerësimin e projektit, për ndërtimi ose rikonstruksioni i godinave të IA-ve publike janë:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore.
2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike.
3. Niveli i ndikimit të projektit: a) në shërbimet bazë, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillim social të zonës në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive, b) në nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në infrastrukturën arsimore, duke adresuar edhe shkakun.
4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve.
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti.
6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto -përfitim etj.
7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni kërkues, etj.

**Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjediseve / godinave** të SAPU-së do të mbulohen me fonde nga transferta e pakushtëzuar miratuar për NJBQV, të ardhurat e veta të NJBQV-ve., Garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre, ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik, garantimi i kushteve higjienike-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike, janë kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë NJBQV.

Çdo bashki dhe komunë vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha

burimet e zotëruara në buxhetin e saj. Ministria përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për mjediset e APU-së.

**Shpenzimet për blerjen pajisjeve, mjeteve didaktike dhe shërbimet** përballohen me fonde tw Buxheti i Shtetit dhe realizohen nga **njësitë qeverisjes vendore**. Për blerjen e pajisjeve, mjeteve dhe shërbimeve të tjera nuk ka rregull të përhershëm se cili institucion është përgjegjës për prokurimin e tyre. Ato përcaktohen me VKM, çdo vit, si rregulla të prokurimit publik, sikundër pajisja e shkollave me mjete didaktike dhe me libra për bibliotekat e shkollave.

**Shpenzimet për transportin e mësuesve**, që punojnë jashtë qendrave urbane, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në distancën mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës, si dhe shpenzimet për transportin e nxënësve që ndjekin arsimin bazë larg vendbanimit, në distancën mbi 2 km, përballohen nga fondet publike. Përfitojnë shpenzime nga fondet publike rreth 8-10% e nxënësve të arsimit 9-vjeçar dhe rreth 35% e mësuesve të SAPU-së.

Do të vijojë kompensimi i çmimit të teksteve shkollore realizohet në mbështetje të VKM-së nr. 107, datë 10.02.2010 "*Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar*". Janë dhënë falas tekstet për nxënësit romë, për nxënësit e shkollave të pakicave kombëtare, për fëmijët shqiptarë emigrantë, për nxënësit nga familjet me ndihmë sociale dhe për ata që kanë statusin e të verbërve. Çmimi i blerjes së tyre mbulohet tërësisht nga buxheti i Ministrisë.

**Bursat dhe mbështetja financiare për nxënësit** nga shtresat sociale në nevojë apo me rezultate në mësime miratohen çdo vit me VKM. Nxënësit që ndjekin studimet në IA-të publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera të parashikuara në këtë vendim; shpenzimet për kuotën ushqimore / bursa mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë. Bursat për çdo nxënës përfitues miratohen nga këshillat e NjBQV-ve dhe nga institucionet e arsimit të lartë, duke u dhënë përparësi nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre nga shtresat në nevojë, si dhe administrohen nga NjBQV-të dhe nga institucionet e arsimit të lartë publik. Bursat akordohen mbështetur në kritere ekonomike (të ardhura të ulëta të familjes) dhe në rezultatet e larta në mësime. Me qëllim nxitjen e të nxënit, vijueshmërisë dhe përparimit të nxënësve romë dhe egjiptianë, me VKM përfitojnë trajtim, bursa studimi, shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe mbulimin e kostos së teksteve mësimore një numër i madh nxënësish e studentësh romë e egjiptianë.

Për t'iu përgjigjur kërkesave dhe për të siguruar barazinë e mundësive për nxënësit dhe rajonet, do të zbatohet modeli i financimit "për nxënës", i cili bazohet në numrin aktual të nxënësve, si dhe në gjeografinë e shtrirjes së shërbimeve të nevojshme, në numrin e mësuesve dhe në stafin mbështetës dhe jo në sasinë e parave të paracaktuara. Formula "për nxënës" u përgjigjet edhe nevojave të kategorive të veçanta dhe bazohet në faktin që një nxënës, p.sh., me AK kushton me shumë.

MAS-i menaxhon kompenson të gjitha shpenzimet e lidhura me botimin e teksteve shkollore, me bursat e nxënësve, me materialet didaktike, si dhe me transportin e mësuesve dhe të nxënësve. Mbajtja e disa shërbimeve në nivel qendror përben përparësi, shërbime si transporti i nxënësve dhe i mësuesve ose bursat mund të realizohen më mirë nga niveli lokal. Edhe pse realizimi i decentralizimit në sistemin arsimor do të rriste efikasitetin për këtë shërbim, duke ulur shpenzimet, planifikimi buxhetor i detajuar është i nevojshëm për të rritur përgjegjshmërinë ndaj këtyre fondeve në të dyja nivelet, qendror dhe rajonal.

Një nga kërkesat kryesore të reformimit të skemës së menaxhimit dhe të financimit të shërbimeve arsimore është ndërtimi dhe funksionimi i modelit të bazuar në kërkesë dhe në performancë. Për këtë, në nivelet e ndryshme të sistemit financiar, do të duhet të zhvillohen kapacitetet, që të përfshihen aktivisht të gjithë aktorët realizues dhe raportues në hartimin e planit të detajuar buxhetor dhe në zbatimin e tij.

Me qenë se MAS-i, nuk merr raportime për sasinë e financimit qe qeveria vendore i akordon sektorit të arsimit në përgjithësi, dhe nen-sektorëve të tij, kjo e ka penguar seriozisht MAS-in që të hartojë një planifikim financiar të besueshëm dhe efektiv. Për kapërcimin e kësaj dukuri, por dhe për të rritur shkëmbimin e informacionit financiar midis MAS-it, MF, qeverisë vendore dhe shkollave, do të përsoset SMIA, që të mbledhë dhe të menaxhojë efektivisht këtë lloj informacioni.

Do të rishikohen praktikat aktuale e sigurimit të të ardhurave nga shkollat, duke synuar rritjen e mbështetjes financiare të arsimit baze, jo vetëm nga qeveria qendrore por edhe nga ajo vendore. Shkollat dhe komunitetet duhet të kenë kontroll të plotë të të ardhurave. Përqindjet që i kalojnë shtetit nga këto fonde duhet të rishikohen, me tendence zvogëlimin e tyre, që të nxiten më shumë komunitetit dhe stafi shkollor. Shkolla duhet lejuar të rritë pavarësinë në përdorimin e të ardhurave të krijuara nga pajisjet dhe nga mjediset e veta, si dhe nga punonjësit që përfshihen jashtë orarit të punës.

MAS-i duhet të rishikojë shpenzimet në IAL sipas modelit "përfituesi i shërbimit paguan koston", me qellim që të favorizojë financimin e niveleve të tjera të arsimit. Fondet shtesë, të përfituara nga burimet e brendshme e të jashtme, duhet të përdoren me përparësi nga APU-ja.

Për vlerësimin e përafërt të kostove të nevojshme për zbatimin e SZhAPU-së janë respektuar programi i buxhetit afatmesëm i MAS-it, për periudhën 2015 - 2017, projektet e ndryshme me financim ose bashkëfinancim me donatorët, që kanë filluar zbatimin apo që mendohet të fillojnë në fusha të veçanta, si dhe llogaritjet për projekte dhe veprimtari të tjera që po kryhen në partneritet me organizma e institucione politike e financiare ndërkombëtare, me qeveritë e vendeve të tjera si dhe me shoqërinë civile, asistenca e të cilave nuk është vetëm teknike, por edhe financiare. Një pjesë e kostove, në varësi të masave, përveç MAS-it dhe institucioneve të tjera të varësisë apo të autoriteteve arsimore vendore e shkollave, do të mund të përballohen nga të ardhurat nga sektori

privat apo shërbimet e tjera të ofruara.

Edhe ndarja e re territoriale do të krijojë mundësi të mira që bashkitë e reja të jenë më të afta të menaxhojnë shkollat me kosto-efektivitet. Kjo situatë mund të përmirësohet më tej përmes partneriteteve me bashkitë fqinje, veçanërisht për shkollat e vogla në periferi të ndarjeve administrative. Gjithashtu, do të pilotohet menaxhimi i shkollave të vogla në grupime me buxhet të përbashkët.

Analiza e politikave dhe planifikimi strategjik shtron nevojën urgjente për vënien në punë të SMIA-s dhe të SMISh-së. Drejtoria e informacionit dhe statistikës, do të bashkëpunojë ngushtësisht me INSTAT për përcaktimin e kategorive dhe të niveleve të përpunimit të të dhënave të sistemit arsimor e më gjerë. Sistemi SMIA nënkupton edhe kërkimin konceptues dhe hetimin analitik të të dhënave për qëllime studimore. SMIA duhet të ketë kapacitetin për të kategorizuar të dhënat ekonomike, infrastrukturore, sociale (përfshirë grupet e minoritetit) dhe arsimore, në nivelet rural, urban dhe qendror, qarku, bashkie, deri në nivel shkolle. Menaxhimi arsimor do të përmirësohet dukshëm nëpërmjet (i) modernizimit të infrastrukturës teknologjike në të tre nivelet, shkollë, njësi vendore arsimore dhe ministri, dhe (ii) zhvillimit të një sistemi informacioni të besueshëm, të shpejtë dhe të saktë informimi.

Në këtë kontekst, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me partnerët e këtij sektori nëpërmjet:

- zhvillimit të kritereve për bashkëpunim me kompani lokale dhe ndërkombëtare, për të siguruar dhe për të ofruar përmbajtje arsimore dixhitale për arsimin bazë dhe të mesëm;
- zhvillimit të një platforme që do mundësojë investime të kompanive të huaja dhe vendase në fushën e TIK-ut në dobi të arsimit.

Në instalimin e SMIA-s dhe SMISh është marrë parasysh kostoja për ngritjen e kapaciteteve (trajnime të ndryshme etj.) dhe kostoja e pajisjeve dhe e mobilimit të laboratorëve etj.

| **B. NXËNIA GJITHËPËRFSHIRËSE DHE CILËSORE[(24)]** | |
|---|---|
| **Objektiva politikë** | **Veprimtari kryesore** |
| B1. Reformimi i kurrikulës së APU. | B1.1 Hartohet, pilotohet dhe zbatohet paketa e re kurrikulare, e krahasueshme me kurrikulat e vendeve të BE-së. |
| | B1.2 Hartohen dhe sigurohen tekstet shkollore dhe parashkollore dhe mjete mësimore cilësore për të gjitha nivelet. |
| | B1.3 Institucionalizohen veprimtaritë sportive në institucionet e APU-së. |
| B2. Gjithëpërfshirja[(25)]. | B2.1 Përfshihen 95% e fëmijëve në APSh dhe në klasat përgatitore. |
| | B2.2 Sigurohet gjithëpërfshirja e nxënësve në arsimin e detyrueshëm, duke siguruar gradualisht të paktën një vit shkollor përgatitor për të gjithë fëmijët (5-6) vjeçar si dhe shërbime të fëmijërisë së hershme dhe prindërimit të mirë tek grupet e margjinalizuara, veçanërisht në zonat VL. |
| | B2.3 Ndërtohet një filozofi e re e gjithëpërfshirjes dhe vihet në zbatim marrëveshja tre ministrore për identifikimin dhe përfshirjen e fëmijëve jashtë shkolle në sistem. |
| B3. Shkolla qendra komunitare. | B3.1 Fuqizohet dhe zgjerohet rrjeti i shkollave qendra komunitare. |
| | B3.2 Krijohen mjedise shkollore miqësore për fëmijët, pa dhunë, mjedise që ndihmojnë, kujdesen dhe kultivojnë vlerat demokratike dhe ofrojnë modele pozitive. |
| | B3.3 Garantohet oferta shkollore përmes treguesve të standardizuar. |
| | B3.4 Zbatohen plane për digjitalizimin e hartës së shkollave dhe optimizohet rrjeti i shkollave |
| B4. Shërbime këshilluese dhe mbështetëse. | B4.1 Koordinohen shërbimet këshilluese në nivel qendror dhe në nivel bashkie dhe ofrohen shërbime profesionale. |
| | B4.2 Sigurohen shërbime dhe kushte të përshtatshme për fëmijët me AK. |
| B5. Digjitalizimi i procesit të nxënies. | B5.1 Përmirësohet digjitalizimi i procesit të nxënies.<br>B5.2 Përdoret interneti në arsim si një mjet burimor për materiale mësimore nga të gjithë nxënësit dhe mësuesit. |

(24) *Praktikat mësimore tregojnë një cilësi të ulët të strategjive të mësimdhënies dhe të mësuarit në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera të OECD-së dhe me vendet e Europës dhe Azisë Qendrore*. BB (2014).
(25) Sigurimi i gjithëpërfshirjes respekton dispozitat e Ligjit 69/12 "Për Arsimin parauniversitar (neni 5) dhe Ligjit 10221 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

## REZULTATET KRYESORE

Duke filluar:

1. Nga viti 2015 e në vijim, sigurohen **tekstet shkollor**e **të reja** dhe **të njësuara**, sipas qasjes së re kurrikulare, për të gjitha nivelet arsimore.
2. Nga viti 2015, tekstet shkollore **për pakicat kombëtare** plotësojnë standardet europiane.
3. Nga viti 2016, zgjerohet **rrjeti i shkollave qendër komunitare** që ofrojnë modele pozitive të sjelljes dhe u mundësojnë fëmijëve të kultivojnë vlerat demokratike.
4. Nga viti 2016, funksionojnë **shoqatat e sportit** dhe **federata kombëtare e sportit**.
5. Nga viti 2017, të gjitha shkollat kanë **shërbime psiko-sociale**.
6. Nga viti 2018, 95% fëmijët e grup-moshës 5-6 vjeç (përfshirë dhe ata me AK) përfshihen në **klasat përgatitore**, ndërkaq 90% e grup-moshës **3-5** vjeç përfshihet **në forma të ndryshme** të edukimit parashkollor që funksionojnë bazuar në kurrikulat përkatëse.
7. Nga viti 2018, funksionon **harta digjitale** e shkollave dhe optimizohet rrjeti i shkollave të mesme.
8. Nga viti 2018, shkollat e mesme janë të pajisura me infrastrukturën e sigurt dhe funksionale që ofron mundësi për përdorimin e **përmbajtjeve digjitale** në procesin mësimor.
9. Nga viti 2019, funksionon sistemi që mundëson **gjithëpërfshirjen e nxënësve** në arsimin e detyrueshëm, i ndjeshëm ndaj nxënësve nga familje të shtresave në nevojë dhe të disavantazhuara(26).
10. Nga viti 2019, zbatohet **kurrikula e re** që bazohet në kompetenca, në të gjitha nivelet e APU-së, e shoqëruar me përmirësimet e nevojshme në metodologjitë e të nxënit dhe të vlerësimit.
11. Nga viti 2020, ka **shërbime mbështetëse** për fëmijët me AK, në IA-të dhe çdo bashki.
12. Nga viti 2017, sigurohet prania e **mësuesve ndihmës** për fëmijët me AK, gjatë orëve të mësimit.

Për APU-në, po zbatohet struktura (5+4+3), e njësuar me strukturën e sistemit arsimor të Kosovës(27). Cikli 9 - vjeçar u realizua për herë të parë gjatë vitit shkollor 2008-2009. Këtij cikli do t’i shtohet viti përgatitor që përfitohet në kuadër të zhvillimit të APSh, i projektuar për t'u shtrirë hap pas hapi. Zbatimi i kësaj strukture do ta afrojë sistemin arsimor shqiptar me sistemet arsimore të vendeve të rajonit dhe të BE-së. Dy nivelet e para të sistemit do të përqendrohen në krijimin e kushteve optimale, në të cilat nxënësit do të ndërtojnë njohuritë themelore dhe kompetencat kyçe. Niveli i tretë do të zhvillojë më tej kompetencat kyçe dhe specifike të nxënësve për jetën e përditshme në një shoqëri demokratike.

---

(26) Vendet e BE-së synojnë që, pas vitit 2020, të përfshihen në APSh, të paktën 95% e fëmijëve (mosha 4 vjeç e sipër); të jenë të pakualifikuar në lexim, matematikë dhe shkencë, më pak se 15% e nxënësve 15-vjeçarë dhe shkollat të braktisen nga më pak se 10% e të rinjve.
[Official Journal of the European Union (2009), *Council conclusions of 12 May 2009 on a strategic framework for European cooperation in education and training (‘ET 2020’)*]

(27) MASHT, (2011). *Korniza e kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*.

Kurrikula e planifikuar, ajo e zbatuar dhe kurrikula e përvetësuar përfaqësojnë bazën e sistemit arsimor. Ndaj, përmirësimi i cilësisë së arritjeve të nxënësve në APU po nis me reformimin e kurrikulës dhe me modernizimin e procesit të nxënies. Kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar integron për herë të parë kurrikulën e APSh me atë të APU-së, duke konfiguruar përmasat e reja të një sistemi arsimimi dhe edukimi nga mosha 3-18 vjeç. Njëherazi, ajo është njësuar me kurrikulën e sistemit arsimor parauniversitar të Kosovës.

Kurrikula e re e APSh mbështet zhvillimin social-emocional, fizik dhe intelektual të fëmijës. Ajo do të sigurojë përfshirjen aktive të fëmijëve në procesin e të nxënit, duke pranuar që fëmijët parashkollorë nxënë nëpërmjet lojës, pjesëmarrjes aktive në mjedisin rrethues, nëpërmjet përvojave konkrete dhe duke komunikuar me bashkëmoshatarët dhe të rriturit. Kurrikula parashikon zhvillimin e një sërë veprimtarish dhe përdorimin e një sërë materialesh didaktike që nxisin zhvillimin e përshtatshëm të fëmijës sipas moshës, mjedisit, nivelit të zhvillimit dhe nevojave individuale, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.

Kurrikula e re e APU-së bazohet në qasjen me kompetenca dhe organizohet sipas një strukture që mbështet zhvillimin e tyre. Struktura e re integron kompetencat sipas fushave të nxënies, shkallëve kurrikule dhe rezultateve të nxënies. Ajo do të zhvillojë shtatë kompetencat kyçe, të krahasueshme me kompetencat e kornizës europiane për nxënien gjatë gjithë jetës, si dhe do të strukturohet sipas rezultateve të nxënies për kompetenca dhe për fusha të nxëni.

Struktura e kurrikulës së re organizohet sipas shkallëve të kurrikulës dhe fushave të nxënies. Koncepti i shkallëve bazohet në karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve dhe siguron kushtet për të respektuar më mirë ritmet e ndryshme në zhvillimin e tyre. Ato të mundësojnë lidhjen e qartë të rezultateve të nxënies përgjatë shkallëve, fleksibilitet më të madh në planifikimin dhe organizimin e punës mësimore-edukative dhe forcimin e përgjegjësisë e të llogaridhënies për cilësinë e arsimit që ofrohet nga shkolla.

Për secilën fushë, përcaktohen rezultatet e të nxënit që mundësojnë zhvillimin e kompetencave kyçe, lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore, zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle. Si e tillë, kurrikula do të sigurojë baraspeshën ndërmjet njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të secilës fushë të nxëni, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.

Kurrikulat e reja përshtatin përmbajtjet kurrikulare dhe procesin e nxënies me kërkesat e zhvillimit moshor, me aspiratat e nxënësve dhe të prindërve. Ato normalizojnë ngarkesën e përmbajtjeve përmes mënjanimit të materialeve të panevojshme dhe rregullimit të kohës mësimore.

Edhe për gjuhët e huaja, MAS-i do të vijojë të bazojë sistemin kurrikular në "*Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët: mësimdhënia, nxënia dhe vlerësimi*" si dokument që

parashtron Standardet Evropiane. Synohet që, deri në fund të klasës XII, nxënësit të mësojnë 2 gjuhë të huaja, ndërsa përvetësimi i gjuhës së parë të arrijë në nivelin $B_2$ (sipas këtij dokumenti).

Aspekt i rëndësishëm i reformës kurrikulare është hartimi dhe botimi i teksteve te reja si një projekt i rëndësishëm që do të ndërmarrë MAS-i. Projekti do të sigurojë përmirësimin e cilësisë së teksteve shkollore, duke siguruar tekste të huaja për fushat e matematikës dhe të shkencave natyrore.

Kurrikulat e reja do të pilotohen për të vlerësuar profesionalisht ndikimin, ndërhyrjet dhe ndryshimet e nevojshme.

Reforma e kurrikulës do të pajisë shkollat me infrastrukturë të sigurt dhe funksionale që ofron mundësi për përdorimin e përmbajtjeve digjitale në procesin mësimor. Futja gjerësisht e TIK-ut në procesin mësimor synon që nxënësit tanë të jenë të përgatitur për tregjet e punës. Për të arritur këtë objektiv, do të zhvillohet një kurrikul bashkëkohore në fushën e TIK-ut, me qëllim aftësimin e nxënësve në përputhje me standardet evropiane. Kjo do të shoqërohet me përmirësimin e infrastrukturës teknologjike.

Gjithashtu, ndjehet nevoja për futjen e teksteve të tjera të referencës, duke filluar me krijimin e bibliotekave në klasa. Përdorimi i TIK-ut në programet e APU-së, do të mundësojë krijimin e bibliotekave me lidhje interneti. Do të vijojë për këtë qëllim mbështetja buxhetore për 1350 shkolla për rrjetin e internetit si dhe zbatimi i platformës e-learning në bashkëpunim me partnerët tanë të rëndësishëm, siç është qeveria austriake.

Për përmirësimin e cilësisë së punës dhe të jetës në shkollat e vendit, MAS-i ka ndërmarrë nismën "Shkolla si Qendër Komunitare - Një shkollë miqësore për të gjithë". Transformimi i shkollës në qendër komunitare, rajonizimi i shkollave që edhe nxënësit në shkollat me numër të kufizuar të kenë mundësinë e arsimimit cilësor, si dhe krijimi i programeve plotësuese falas do të shërbejnë për të mbyllur përfundimisht kapitullin e cenimit të ligjit të arsimit parauniversitar. Legjislacioni ynë për arsimin, aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe dokumente të tjera do të mbështetin funksionimin e një shkolle të hapur për vendimmarrje të përbashkët me familjen dhe komunitetin.

Projekti i shkollës si qendër komunitare do të mundësojë sigurimin e një arsimi cilësor për çdo nxënës, në mjedise që mundësojnë kultivimin e vlerave demokratike, sigurimin e mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve, angazhimin dhe zhvillimin e komunitetit, vendimmarrje të përbashkëta, respektimin e shumëllojshmërisë dhe përdorimin e burimeve komunitare në shërbim të shkollës.

Në këtë kontekst, me përparësi do të trajtohet ndërtimi i një filozofie të re të gjithëpërfshirjes në institucionet arsimore, duke siguruar përfshirjen e gjitha grupeve të cenueshme në arsim (fëmijë romë, egjiptianë, me AK, pakica kombëtare etj.) në të gjitha nivelet arsimore, sidomos në atë

parashkollor dhe në klasat përgatitore.
Investimeve shkollore do të realizohen, duke iu referuar hartës shkollore. Harta do të përdoret jo vetëm për të parë dhe për të ndërtuar me përparësi për të gjitha nevojat që ka infrastruktura shkollore, duke hetuar se cilat janë shkollat në shkallë rrezikshmërie të lartë me nevoja emergjente për ndërhyrje. Gjithashtu, harta do të lehtësojë vendimmarrjet në aspektin e mikro-shkollave. Në Shqipëri, në vitin 2014, pati mbi 1 mijë shkolla të tilla, me shumë pak nxënës, në të cilat ishin prezent mësimdhënia jo cilësore dhe mungesa e mësuesve me arsimin përkatës. Përmes projekteve konkrete që integrojnë rrezikshmërinë, prioritetet për ndërhyrje, rajonizimin dhe reformën territoriale, do të adresohet procesi i ndërhyrjeve në infrastrukturë.

Edhe rajonizimi dhe rigrupimi i IA-ve[(28)] është në funksion të nxënies gjithëpërfshirëse cilësore.

SZhAPU-ja fokusohet, si asnjëherë tjetër, në krijimin e kushteve që sigurojnë realisht arsim për të gjithë fëmijët, pavarësisht kushteve dhe rrethanave vetjake. Reformimi i kurrikulës dhe mbështetja me të gjitha mjetet e projektit për kthimin e shkollave në qendra komunitare janë disa nga parakushtet që mundësojë përfshirjen e të gjithë fëmijëve në IA-të. Normalizimi i numrit të nxënësve në klasa (jo më shumë se 30 nxënës për klasë) është një tjetër parakusht në funksion të plotësimit të objektivit të gjithëpërfshirjes. Nga ana tjetër, Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012 (neni 46) dhe Urdhri nr. 344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social" i hapin rrugën rruajtjes së cilësisë së shëndetit mendor të nxënësve dhe asistencës profesionale për grupet e fëmijëve me nevoja arsimore të veçanta ose AK. Strategjia ka parashikuar masat e nevojshme për shtrirjen e shërbimit në zonat urbane dhe ato rurale, në të gjithë fëmijët e moshës nga 0 deri 18 vjeç. Shërbimi psiko-social do të ofrojë mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, për vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale dhe për hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Hartimi politikave të reja për rishikimin e lëndës së edukimit fizik konceptimi bashkëkohor i veprimtarive sportive, krijimi si dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së Federatës së Sportit Shkollor dhe i Shoqatave sportive në IA janë aspekti të cilit i është kushtuar kujdes i posaçëm në këtë strategji. Promovimin e vlerave që lindin nga kërkesat për sportin në përgjithësi dhe të fushës mësimore të edukimit fizik si dhe organizimi dhe monitorimi i projekteve me qëllim afrimin e fëmijëve dhe të rinjve me kulturën sportive do të bëjnë të mundur edukimin e një stili jetese të shëndetshëm e aktiv, si një tjetër parakusht thelbësor për nxënien gjithëpërfshirëse cilësore.

Gjithë sa më sipër, ndikohen jo pak nga niveli profesional i mësuesve dhe drejtuesve arsimorë. Duke pasur parasysh se një nga objektivat e reformës është përafrimi i kapaciteteve dhe i sistemit

(28) Në vitin 2014, rreth 30 mijë nxënës e kishin shkollën mbi 1 kilometër larg nga vendbanimi dhe rreth 11 mijë mësues banonin më shumë se 5 kilometër larg nga vendi i tyre i punës.

arsimor me ato të vendeve të BE-së, mësuesia në Shqipëri do të shihet si shërbim publik. Një trajtim i tillë dhe rregullimi i kohës së punës do të rritë angazhimin nga ana e mësuesve dhe do të justifikoje shtimin e rrogës bazuar në rritjen e kohës dhe cilësisë së punës. Ngarkesa duhet të jetë e matshme dhe e kontrollueshme. Këto veprime pritet të ulin numrin total të mësuesve, të ndihmojnë përmirësimin e raportit mësues/nxënës dhe do ta bëjnë sistemin arsimor shqiptar të krahasueshëm me sistemet e vendeve të tjera.

| C. SIGURIMI I CILËSISË SË ARRITJEVE BAZUAR NË STANDARDE | |
|---|---|
| **Objektiva politikë** | **Veprimtari kryesore** |
| C1. Ristrukturimet institucionale. | C1.1 Krijohet dhe zbatohet kuadri i ri ligjor për sigurimin e cilësisë në arsim, sipas filozofisë së kurrikulës së re. |
| | C1.2 Ristrukturohen dhe fuqizohen institucionet për inspektim, për vlerësim dhe për licencim. |
| C2. Ndërtimi dhe fuqizimi i kapaciteteve. | C2.1 Ngrihen kapacitetet për hartimin dhe përdorimin e mjeteve të vlerësimit të kompetencave dhe për përdorimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore të vlerësimit. |
| C3. Monitorimi i cilësisë dhe përdorimi i treguesve ndërkombëtarë në monitorim dhe vlerësim. | C3.1 Zhvillohen treguesit kombëtarë arsimorë dhe ngrihet sistemi i monitorimit të tyre. |
| | C3.2 Fuqizohet procesi i vetëvlerësimit dhe vlerësimit të arritjeve të shkollave. |
| | C3.3 Organizimi i testimeve kombëtare sipas shkallëve kurrikulare për qëllimeve studimi. |
| | C3.4 Sigurohet pjesëmarrja aktive në projekte të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. |
| C4. Ristrukturimi i provimeve kombëtare. | C4.1 Organizimi i provimit të "Maturës shtetërore" vetëm si provim dalës. |

**REZULTATET KRYESORE**

Duke filluar:

1. Nga viti 2015, ekzistojnë **baza ligjore** dhe **standardet** për sigurimin e cilësisë.
2. Nga viti 2015, ekzistojnë **mekanizma efikasë për akreditimin dhe licencimin** e institucioneve dhe të programeve.
3. Nga viti 2015, zbatohet **karta e performancës** së shkollës.
4. Nga viti 2015, ministria prodhon **raportin vjetor të performancës** së SAPU-së.
5. Nga viti 2016, funksionojnë **mekanizmat për monitorimin, inspektimin, vlerësimin**.
6. Nga viti 2016, ekzistojnë **mekanizma efikasë për vlerësimin e kompetencave** të nxënësve dhe përdoren **metoda dhe të teknika bashkëkohore vlerësimi**.
7. Nga viti 2016, ISHA organizohet dhe vepron **në nivelin qendror dhe rajonal**.
8. Nga viti 2016, matura shtetërore realizohet si **provim dalës**.
9. Nga viti 2018, sistemi arsimor monitorohet përmes **treguesve ndërkombëtarë**.

Arritja e këtyre rezultateve kërkon ndryshim filozofik thelbësor, i cili nuk ka të bëjë vetëm me

bërjen e politikave, por edhe me monitorimin, me vlerësimin dhe me raportimin. Vlerësimi i arritjeve si procesi përmes të cilit mblidhen sistematikisht të dhëna, analizohen dhe interpretohen ato, që të përcaktohet masa e përmbushjes së objektivave si dhe vetëvlerësimi i individit ose i strukturave të caktuara të sistemit arsimor, do të konsiderohen si instrumente matëse të fuqishme dhe si procedura që do të përdoren sistematikisht.

Për të arritur besueshmërinë ndaj përfundimeve të bazuara në metodën e vetëvlerësimit, do të alternohet monitorimi periodik i jashtëm me atë të brendshëm. Organizimi i inspektimit me dy nivele, qendror dhe lokal, do të mundësojë monitorimin e koordinuar (të jashtëm dhe të brendshëm) të zhvillimit të shërbimit arsimor, duke mundësuar krahasimin e cilësisë së performancës së IA-ve dhe të individëve në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Sistemi i dyfishtë i monitorimit do të nxit përdorimin e mënyrave të shumta për raportimin dhe për mbikëqyrjen, do të rritë transparencën e procesit dhe besueshmërinë e përfundimeve të arritura.

Kombinimi i monitorimit të brendshëm me atë të jashtëm do të mundësojë ndërmarrjen e veprimeve të efektshme për përmirësime në formën e asistencës nga njësitë e specializuara lokale dhe kombëtare. Nëse një shkollë nuk arrin të përmbushë standardet e veta dhe objektivat e arritjeve të nxënësve, të përcaktuara në planet e veta zhvillimore, atëherë përgjegjësia i mbetet stafit pedagogjik dhe drejtuesve të shkollës. Në raste të tilla, qeveria vendore, e bazuar në përgjegjësitë e transferuara në kuadër të decentralizimit të sektorit arsimor, mund të kufizojë përgjegjësitë e deleguara tek shkolla dhe të shpërndajë bordin e shkollës.

Roli i inspektorëve, deri tani, është parë më shumë si mekanizëm ndëshkues dhe kontrollues. Kjo do të ndryshojë, pasi dëshirojmë që profesionistët në arsim të jenë novatorë dhe të përfshihen në procesin e vetëzhvillimit. Opsioni më i mirë për rolin e inspektoreve do të jetë sigurimi i mbështetjes. Ky ndryshim konceptues ka rendësi për suksesin e procesit të "vete-raportimit", si pjesë e sigurimit të cilësisë dhe të monitorimit. Që individët të raportojnë me ndershmëri, ata duhet të kenë besim te sistemi. Performanca e sistemit të inspektimit dhe kualifikimi i inspektoreve të nivelit qendror dhe rajonal, do të vlerësohet si i rëndësishëm.

IShA të riorganizohet në dy nivele. Niveli qendror të shërbejë si njësi bazë për hartimin e orientimeve dhe të udhëzimeve për procesin e inspektimit, për planifikimet e ushtrimit të inspektimeve në nivel kombëtar dhe vendor, për mbledhjen dhe për përpunimin e të dhënave, për inspektimin dhe raportimin e cilësisë së arritjeve në nivel shtetëror, vendor dhe institucional etj. Zyrat e inspektimit të nivelit rajonal, të varura nga niveli qendror, të funksionojnë si njësi operative që, në bashkëpunim me inspektoratin qendror, realizojnë të gjitha llojet e vlerësimeve të jashtme dhe të verifikojnë dhe vlerësojnë zbatimin e kuadrit ligjor në institucionet arsimore.

Krahas hartimit dhe miratimit të kuadrit rregullator (standardet për sigurimin e cilësisë, treguesit e arritjeve dhe instrumentet për licencimin dhe akreditimin), një instrumentet tjetër që do të përdoret

për fuqizimin e sistemit të sigurimit të cilësisë do të jetë karta e performancës shkollore. Karta është sistem i projektuar për informacion dhe dobi. Ajo do të ofrojë të dhëna për arritjet e shkollës gjatë një viti shkollor, do të garantojë cilësinë e ofertës së shkollës përmes treguesve të standardizuar dhe do të shërbejë si mjet për vetëvlerësimin e shkollës dhe për inspektimin**.** Karta do t'u shërbejë prindërve, drejtuesve**,** mësuesve, nxënësve, njësive arsimore vendore, komunitetit dhe gjithë të interesuarve, që të analizojnë dhe të krahasojnë rezultatet e shkollës me tregues të ndryshëm të arritjeve. Njohja me rezultatet e treguesve do të ndihmojë prindërit dhe komunitetin të gjykojnë për arritjet dhe për nevojat për përmirësim, duke mundësuar përfshirjen reale edhe në vendimmarrje.

Përmirësimit të performancës së sigurimit të cilësisë do t'i shërbejë edhe përgatitja e raportit vjetor të arritjeve të SAPU-së. Kjo do të mundësohet nga përmirësimi i infrastrukturës informatike, nga kthimi në praktikë rutinë i mbledhjes së të dhënave bazuar në treguesit e ecurisë së reformës, nga raportet e inspektimit dhe nga burime të tjera.

Riorganizimi i AKP-së dhe konceptimi e organizimi i ri IShA-s do të shënojnë fillimin e dy reformave të rëndësishme institucionale. Ristrukturimi organizativ do të plotësohet me zhvillimin e burimeve njerëzore për të forcuar kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese. Për të rritur efektivitetin e AKP-s, MAS-i parashikon vendosjen e një sistemi të dyfishtë, i cili përfshin monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm e te jashtëm, duke shtrire ekspertizën e Agjencisë jo vetëm në provimet finale, por dhe në vlerësime dhe analiza të vijueshme me tematika e objektiva të caktuara.

Kapaciteti aktual i AKP-se, duhet të zgjerohet, duke përfshirë ekspertë të cilët do të hartojnë tregues efikasë për matjen e nivelit të ndërtimi dhe të përdorimit të kompetencave kyçe dhe të njohurive të reja. Agjencia ka nevojë për pajisje bashkëkohore që të përmbushë detyrën e saj dhe të përdorë me sukses tregues kombëtarë dhe ndërkombëtarë të arritjeve. Nisur nga synimi i përgjithshëm politik i sigurimit të kapaciteteve të afta për integrimin në BE, është tejet e nevojshme të zhvillohen treguesit kombëtarë arsimorë të krahasueshëm me ata ndërkombëtarë, si dhe sistemi i monitorimit të tyre. AKP-ja ka ende nevojë për krijimin dhe për zhvillimin e kapaciteteve për të krahasuar rezultatet e arritjeve me vende të ndryshme të rajonit nëpërmjet grupit të treguesve të monitorimit të ecurisë së shërbimit arsimor.

Ndryshon provimi i Maturës shtetërore. MSh do të jetë provim dalës nga shkolla e mesme, por jo provim për t'u pranuar në shkollat e larta. Kjo pasi ne kemi nevojë t'i japim shumë më tepër vend meritës dhe të krijojmë shumë më tepër hapësirë për konkurrencën që ia jep merita. Ristrukturimi i MSh do të sigurojë që rezultatet e provimeve të jenë të krahasueshme midis nxënësve, shkollave dhe njësive arsimore vendore. Kjo lidhet krahas tw tjerave edhe me ndryshimin e strukturës së testeve të provimeve kombëtare dhe me rishikimin e përmbajtjes së pyetjeve, sasinë e pikëve dhe peshat e niveleve të vështirësisë (testi duhet të jetë të paktën me 100 pikë, për një vlerësim më të zgjeruar të njohurive dhe të kompetencave të nxënësve).

| D. PËRGATITJA DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL | |
|---|---|
| **Objektiva politikë** | **Veprimtari kryesore** |
| D1. Profesionalizimi i mësuesisë. | D1.1 Krijohet dhe zbatohet baza ligjore për sigurimin e cilësisë së arritjeve sipas kurrikulës së re |
| | D1.2 Ndërtohen sisteme koherente për stazh, licencim fillestar dhe rekrutim. |
| | D1.3 Përmirësimi i standardeve profesionale dhe i statusit të mësuesit. |
| | D1.4 Zhvillimi i vazhduar profesional i specialistëve |
| | D1.5 Licencimi periodik me bazë performancën. |
| D2. Zbatimi i një reforme tërësore për zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave . | D2.1 Zhvillohen kapacitetet për vlerësimin e nevojave për ZhP-në. |
| | D2.2 Akreditohen programet e ZhP-së. |
| | D2.3 Certifikohen periodikisht trajnerët. |
| | D2.4 Ndërtohet sistemi për administrimin e të dhënave për ZhP-në. |
| | D2.5 Fuqizohen mekanizmat për qëndrueshmërinë e ZhP-në në shkollë |
| | D2.6 Monitorohen dhe vlerësohen trajnimet |
| | D2.7 Bashkëpunohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për ZhP-në |
| D3. Cilësia e formimit akademik dhe pedagogjik të mësuesit. | D3.1 Harmonizohen programet e studimit me politikat e MAS-it. |
| | D3.2 Zhvillohen projekte nga departamentet e FE-së për hulumtime. |
| | D3.3 Nxiten studentë cilësorë që të ndjekin FE-të. |

## REZULTATET KRYESORE

Duke filluar:

1. Nga viti 2015, funksionojnë kapacitetet për **vlerësimin e nevojave** për ZHP-në.
2. Nga viti 2016, akreditohen **të paktën 50 programe** për ZHP-në, bazuar në nevojat.
3. Nga viti 2015, funksionojnë mekanizmat për **monitorimin** dhe **vlerësimin e** programeve të ZHP-së dhe të ndikimit të tyre.
4. Nga viti 2016, **udhëzimet administrative** për ZHP-në janë harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi dhe janë duke u zbatuar.
5. Nga viti 2016, specialistët e Ministrisë, të njësive arsimore vendore dhe drejtorët e shkollave

janë trajnuar me **programe të akredituara** për udhëheqje dhe menaxhim.

6. Nga viti 2016, Ministria, në bashkëpunim me IZHA-n dhe AKP-në, **certifikon trajnerët** e programeve për ZHP-në.
7. Nga viti 2016, **programet e FE-ve** janë të harmonizuara me politikat e Ministrisë dhe i gjithë personeli i FE-ve është aftësuar përmes programeve të ZHP-së.
8. Nga viti 2017, ka përfunduar licencimi i të gjithë mësuesve në sistem dhe **5% e tyre zotërojnë më shumë se një licencë**.
9. Nga viti 2017, funksionojnë **mekanizma** të qëndrueshëm për ZHP në shkollë.
10. Nga viti 2016, funksionon sistemi për administrimin e të dhënave për ZHP-në.
11. Nga viti 2017, përdoren instrumente për bashkëpunim në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të institucioneve tona arsimore të çdo niveli.

Ndërtimin e një sistemi bashkëkohor për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të vazhduar të specialistëve, të mësuesve dhe të drejtuesve, Strategjia e konsideron përparësi strategjike. Por, një sistem i zhvillimit profesional, qofte edhe i mirë menduar, është vetëm mjet që mundet te mos përdoret nga mësuesit në përgjithësi, nëse nuk përmbushen disa parakushte të rëndësishme. Strategjia niset nga kjo konsideratë dhe planifikon të adresojë pikërisht procesin e kushteve si:

- Lidhja organike e procesit të formimit të mësuesve me proceset e trajnimit dhe të kualifikimit të tij gjatë plotësimit të detyrës.
- Liria profesionale të mësuesit për të kontribuar në hartimin e kurrikulës shkollore.
- Përgjegjshmëria e institucionalizuar për arritjet e nxënësve, kryesisht nëpërmjet hartimit dhe përmbushjes së rezultateve të nxënies dhe objektivave të vlerësimeve të jashtme të standardizuara;
- Kritere profesionale të rekrutimit dhe zbatimit të paanshëm të tyre.
- Paga motivuese për statusin social të mësuesit;
- Koha e qëndrimit më e madhe në shkollë e mësuesve;
- Autonomia financiare e shkollës për plotësimin e nevojave infrastrukturore dhe profesionale;
- Hapësira e mjaftueshme për projekte shkollore në dobi të zhvillimit profesional.

Programet e formimit të mësuesve duhet të përfshijnë metodologjitë e kërkimit dhe të hulumtimit, që mësuesit e rinj të jenë në gjendje të zbatojnë kërkimin arsimor në praktikën shkollore. Njohja e tyre me shkollën dhe me nxënësit duhet të nisë që me fillimin e studimeve. Programet e reja, për të gjitha kategoritë e mësuesve, të reflektojnë risitë e kurrikulës së APU-së, të pasurohen me lëndën e TIK-ut dhe me teknikat e hartimit të testeve për vlerësimin e nivelit të zhvillimit të kompetencave. Të gjitha këto, pritet të sigurojnë që studentët të vijnë në auditorë për të diskutuar dhe jo për të riprodhuar ato që u janë dhënë në leksion, në libra dhe në materiale të tjera, të shtypura apo në formë elektronike.

Modeli i ri i formimit të mësuesve, drejt përafrimit me modelet më të përparuara europiane,

ndihmohet edhe nga fuqizimi i qendrave të ekselencës në fakultetet që përgatitin mësues. Këto qendra mund të ndihmojnë studentët për përsosjen e kompetencave profesionale, të aftësive dhe të kapaciteteve të nevojshme për kërkimin arsimor, si dhe mund të aktivizohen fuqimisht si operatorë profesionalë në tregun e shërbimeve trajnuese. Gjithashtu, qendrat mund të ndihmojnë në përgatitjen e mësuesve mentorë. Pjesë e tyre të jenë dhe shkolla ku mësuesit e ardhshëm zhvillojnë praktikën pedagogjike.

Sistemi i reformuar i trajnimit të punonjësve arsimorë:

- të konceptohet, të planifikohet dhe të administrohet mbi bazën e dokumenteve politike arsimore kombëtare, vendore dhe institucionale për trajnim;
- të administrohet mbështetur mbi standardet e sigurimit të cilësisë;
- të plotësojë nevojat e mësuesve/drejtuesve për përsosjen e kompetencave profesionale;
- të sigurojë liri në përzgjedhjen e ofertave për trajnim nga të interesuarit;
- të ofrohet nga agjenci trajnimi të akredituara;
- të kushtëzojë arritjet në trajnimet e mësuesve me arritjet e tyre në punë;
- të lidhë ecurinë në karrierë me pagën;
- të sigurojë funksionimin e shkollës si organizatë profesionale e të nxënit;
- t'u japë shkollave autonomi për përdorimin e fondeve qeveritare ose joqeveritare për të përmbushur objektivat e planit të trajnimit në nivel institucional.
- të marrë parasysh edhe të kreditojë për teknika të përdorura gjerësisht nga përvoja botërore si "komunitete të përbashkëta të mësueseve", për të ndarë përvojat e tyre dhe eksperiencat më të mira.

Plotësimi i objektivave të mësipërme të arrihet përmes koordinimit të MAS-it me institucionet e saj vartëse dhe me agjencitë që ofrojnë shërbime trajnimi. Në këtë kontekst:

- Trajnimi të konceptohet si e drejtë dhe si detyrë e të gjithë mësuesve dhe si përgjegjësi e MAS-it, e njësive arsimore vendore dhe e institucioneve arsimore.
- MAS-i të ofrojë programe shtetërore trajnimi për punonjësit arsimorë dhe të hartojë për këtë qëllim marrëveshjet e duhura me institucionet përkatëse.
- Njësitë arsimore vendore të financojnë programe kualifikimi të mësuesve, ofruar nga agjenci trajnuese me programe trajnimi të akredituara, të përzgjedhura me konkurrim të hapur, sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrit.
- Ministria, njësitë arsimore vendore dhe shkollat të kujdesen për përdorimin e TIK-ut nga të gjithë punonjësit arsimorë, pavarësisht specializimit të tyre dhe të hartojnë e të mbështetin programe në këtë fushë.
- Institucioni arsimor të njohë mësuesit dhe specialistët me objektivat e politikave arsimore institucionale, vendore dhe qendrore dhe me ofertat për trajnim.

Ofruesit e trajnimeve mund të jenë agjenci të akredituara:
- qeveritare ose joqeveritare;
- publike ose private;
- vendase ose të huaja;
- të vendeve te tjera ose ndërshtetërore;
- të subvencionuara ose jo nga shteti.

Trajnimi i mësuesit të baraspeshojë të drejtën e individit me detyrën për trajnim. Ai, ndërkaq, është dhe nevojë e shtetit për të përmirësuar arsimin ndaj, për rrjedhojë, duhet të mbizotërojë financimi publik. Punonjësit arsimorë do të trajnohen të paktën 3 (tri) ditë në vit, me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit. Përqindja e buxhetit arsimor qeveritar të përcaktohet mbi bazën e ligjit, i cili vendos kufirin e poshtëm të kësaj përqindjeje. (p.sh., të paktën 3% e Buxhetit të Shtetit për arsimin parauniversitar të shpenzohet për trajnimin e punonjësve arsimorë). Shpërndarja e financimit për trajnim të jetë e veçantë dhe të realizohet sipas formulës "për punonjës".

MAS-i duhet të veçojë dhe t'u dërgojë njësive arsimore vendore një fond, për t'ua dhënë shkollave që kanë nevojë për shtesë të fondeve publike për trajnime. Kjo nevojë duhet të identifikohet sipas treguesve të efektivitetit të shkollës. Shteti duhet të marrë përsipër shpenzimet e mësuesit për trajnimet që kontribuojnë për titujt e karrierës së tij dhe për shërbimin në qendrat këshillimore publike, por jo për shpenzimet për trajnime që nuk janë të planifikuara nga shkolla dhe për këshillime në qendra private këshillimore.

Gjithashtu, e drejta për të ushtruar detyrën e drejtuesit të shkollës do të sigurohet përmes një licence të njohur nga MAS-i, e vlefshme për një periudhë të caktuar kohore. Sigurimi i licencës për dhe rifitimi i saj në përfundim të afatit të caktuar të arrihet pas një procesi trajnues, pa shkëputje nga puna, përmes moduleve që ofrojnë njohuri dhe kompetenca profesionale në funksion të udhëheqjes së shkollës. Licenca të fitohet pas vlerësimit të paketës profesionale të aspiruesit për drejtues dhe të marrjes së provimit përfundimtar.

Institucionet kryesore të sistemit të formimit dhe të zhvillimit profesional të drejtuesve do të jenë MAS-i, IZhA dhe Fakultetet që formojnë mësues.

Kualifikimi i punonjësve arsimore do të jetësohet në funksion të plotësimit të nevojave, interesave dhe të cilësisë së formimit të nxënëseve dhe të nxënësve.

MAS-i do të ristrukturojë dhe do të qartësojë mekanizmat dhe procedurat përmes të cilave ofrohet shërbimi dhe të sigurohet cilësia e kualifikimit, veçanërisht:

- Shkallët e karrierës së punonjësve arsimorë.
- Rolet profesionale.

- Sistemin e krediteve.
- Politikën për kualifikimin e mësuesve pa arsim përkatës.
- Paketën profesionale të punonjësit arsimor.

Do të reformohet kualifikimi periodik i punonjësve arsimorë (mësues, drejtues shkollash, punonjës socialë, psikologë, etj.), duke e bazuar procesin dhe arritjet mbi treguesit e vlerësimit të vazhduar të punonjësit që kualifikohet. Punonjësi arsimor që nuk e fiton kategorinë e kualifikimit në provim dhe riprovim, të konsiderohet i paaftë për të ushtruar profesionin.

Pas vitit 2016, të gjithë punonjësit arsimor nën moshën 55 vjet duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë dhe të kenë marrë licencën për ushtrimin e profesionit. Punonjësit arsimorë mbi këtë moshë, duhet të kenë dëshmuar, përmes provimit përkatës, zotërimin e kompetencave profesionale të kërkuara. Do të zhvillohet procesi i licencimit dhe akreditimit të mësuesve, si dhe zbatimi i procedurave për monitorim të vijueshëm. Licencimi i mësuesve do të shërbejë si parakusht për të zënë një vend pune si mësues. Procedura e kërkesës për vend pune, e miratimit dhe e zgjidhjes së konflikteve do të hartohet dhe do të miratohet formalisht nga Qeveria dhe MASH-i. Kjo duhet të realizohet së bashku me përsosjen e strukturave akredituese dhe reformimin e programeve të trajnimit të mësuesve.

Reforma arsimore synon një sistem arsimor modern, i cili të nxitë rritjen e qëndrueshme ekonomike, konsolidimin e demokracisë si dhe suksesin në dialogun dhe konkurrencën me vendet e rajonit dhe më gjerë. Reforma që po ndërmerret shërben si mbështetje reale për realizimin e nismave qeveritare.

***Reforma, në kontekstin e SAPU-së, do të sjellë ndryshime që përmirësojnë cilësinë e arritjeve, efikasitetin dhe eficiencën në përdorimin e burimeve, me përparësi krijimin e kulturës së re të nxënies.***

# 4 SEKSIONI

## BURIMET FINANCIARE SIPAS PËRPARËSIVE

**Pasqyra 1. Financimi për synimin strategjik A – Përsosja e qeverisjes, e udhëheqjes dhe e menaxhimit të burimeve (në 000 lekë)**

| Nr. | Veprimtari kryesore | Fondet e parashikuara për periudhën 2014-2020 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rishikohet baza ligjore dhe hartohet legjislacioni i ri (MAS) | 1,076,928.4 | 145,000 | 148,200 | 150,600 | 153,612 | 156,684 | 159,818 | 163,014 |
| 2 | Zbatohet legjislacion i ri ose i përditësuar (DAR/ZA) | 3,388,812.0 | 458,500 | 418,260 | 474,852 | 490,400 | 500,700 | 514,000 | 532,100 |
| 3 | Ndërtohen kapacitetet e reja njerëzore për qeverisjen, udhëheqjen e menaxhimin (MAS/DAR/ZA) | 129,783.5 | 15,000 | 16,000 | 18,000 | 19,600 | 19,992 | 20,392 | 20,800 |
| 4 | Ndërtohet infrastruktura për përpunimin e të dhënave në arsim (MAS/DAR/ZA) | 635,500.0 | 49,500 | 108,000 | 60,000 | 100,000 | 103,000 | 106,000 | 109,000 |
| 5 | Përcaktohen dhe zbatohen procedurat për vlerësimin / vetëvlerësimin e qeverisjes së IA-ve (Auditim / Inspektim) | 432,391.0 | 52,000 | 50,470 | 60,780 | 65,300 | 66,606 | 67,938 | 69,297 |
| 6 | Sigurohen pjesëmarrja dhe transparenca e plotë në procesin e marrjes së vendimeve (IT) | 15,291.9 | 1,500 | 1,800 | 2,100 | 2,400 | 2,448 | 2,497 | 2,547 |
| 7 | Përmirësohen mekanizmat për hartimin / zbatimin e planeve të zhvillimit të IA-ve | 474,012.6 | 60,000 | 55,500 | 70,000 | 70,000 | 71,400 | 72,828 | 74,285 |
| 8 | Mbarten kompetencat nga niveli qendror në nivelin bashkiak dhe nga bashkitë te shkolla (Trajnim drejtorëve të shkollave) | 59,044.5 | 6,200 | 7,500 | 8,250 | 9,000 | 9,180 | 9,364 | 9,551 |
| 9 | Koordinohen veprimtaritë mes udhëheqjeve arsimore dhe sektorëve të tjerë, për financimin e shërbimeve arsimore (Min. e linjës dhe NjBQV-të) | 42,055,336.0 | 1,867,121 | ,949,030 | 3,644,635 | 5,576,488 | 7,083,725 | 9,927,490 | 12,006,847 |
| | **Gjithsej:** | **48,267,099.9** | **2,654,821** | **2,754,760** | **4,489,217** | **6,486,800** | **8,013,735** | **10,880,326** | **12,987,440** |

**Pasqyra 2. Financimi për synimin strategjik B - Nxënia gjithëpërfshirëse cilësore (në 000 lekë)**

| Nr. | Veprimtari kryesore | Fondet e parashikuara për periudhën 2014-2020 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartohet, pilotohet dhe zbatohet paketa e re kurrikulare, e krahasueshme me vendet e BE-së | 343,867.9 | 37,416 | 43,100 | 46,640 | 51,800 | 53,354 | 54,955 | 56,603 |
| 2 | Hartohen dhe sigurohen tekstet e reja shkollore dhe mjetet mësimore cilësore | 1,883,579.3 | 246,000 | 252,000 | 256,000 | 270,000 | 278,100 | 286,443 | 295,036 |
| 3 | Përfshihen fëmijët në APSh dhe në klasa përgatitore | 24,000,720.2 | 3,100,960 | 3,141,520 | 3,225,140 | 3,473,804 | 3,578,018 | 3,685,359 | 3,795,919 |
| 4 | Sigurohet gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin bazë | 148,866,992.8 | 20,057,711 | 20,262,200 | 20,456,548 | 21,056,020 | 21,687,701 | 22,338,332 | 23,008,482 |
| 5 | Fuqizohet dhe zgjerohet rrjeti i shkollave qendra komunitare | 51,269.0 | 4,800 | 6,000 | 7,000 | 8,000 | 8,240 | 8,487 | 8,742 |
| 6 | Sigurohen shërbime riaftësuese të përshtatshme për fëmijët me AK | 916,368.8 | 113,113 | 119,400 | 125,760 | 133,400 | 137,402 | 141,524 | 145,770 |
| 7 | Krijohen mjedise miqësore në shkolla, nxënësit dhe mësuesit përfitojnë transport (Nxënësit që udhëtojnë mbi 2 km nga vendbanimi në shkollë si dhe mësuesit që udhëtojnë mbi 5 km nga vendbanimi në shkollë përfitojnë transport falas) | 4,397,521.3 | 540,000 | 580,000 | 600,000 | 640,000 | 659,200 | 678,976 | 699,345 |
| 8 | Koordinohen shërbimet këshilluese në nivel qendror dhe në nivel bashkie dhe ofrohen shërbime profesionale | 227,751.5 | 28,000 | 28,700 | 30,900 | 33,500 | 34,505 | 35,540 | 36,606 |
| 9 | Përfundon harta e shkollave dhe plotësohet rrjeti me shkolla të reja, ristrukturohen dhe ndërtohen mjediset shkollore, plotësohen me pajisje mobilierie, laboratorët K-B-F si dhe biblioteka shkollore | 39,640,000.0 | **4,300,000** | **4,330,000** | **4,800,000** | **5,668,000** | **6,155,000** | **6,470,000** | **7,917,000** |
| 10 | Përmirësohet dhe funksionon digjitalizimi i procesit të nxënies | 286,681.4 | 2,500 | 25,000 | 30,000 | 50,000 | 51,500 | 53,045 | 54,636 |
| 11 | Institucionalizohen veprimtaritë sportive në shkolla - mjete didaktike e investime në mjedise sportive | 4,269,227.0 | 450,000 | 495,000 | 544,500 | 598,950 | 658,845 | 724,730 | 797,202 |
| | **Gjithsej:** | **224,883,979.1** | **28,900,500** | **29,282,920** | **30,122,488** | **31,983,474** | **33,301,865** | **34,477,390** | **36,815,343** |

**Pasqyra 3. Financimi për synimin strategjik C - Sigurimi i cilësisë së arritjeve (në 000 lekë)**

| Nr. | Veprimtari kryesore | Fondet e parashikuara për periudhën 2014-2020 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Krijohet dhe zbatohet baza ligjore për realizimin e shërbimit arsimor, përmirësimin e kapacitete dhe sigurimin e cilësisë, sipas kurrikulës së re | 39,564,510.1 | 5,236,552 | 5,302,441 | 5,577,920 | 5,688,944 | 5,802,723 | 5,918,777 | 6,037,153 |
| 2 | Ristrukturohen, pajisjen dhe fuqizohen institucionet arsimore për realizimin e shërbimit arsimor për inspektim, për vlerësim dhe për licencim | 11,745,738.0 | 1,571,738 | 1,537,000 | 1,800,000 | 2,190,000 | 1,344,000 | 1,513,000 | 1,790,000 |
| 3 | Fuqizohen kapacitetet për hartimin dhe përdorimin e mjeteve të vlerësimit të kompetencave dhe për përdorimin në mësim të metodave dhe teknikave bashkëkohore të vlerësimit | 979,989.0 | 99,398 | 121,300 | 128,400 | 150,800 | 155,324 | 159,984 | 164,783 |
| 4 | Sigurohet pjesëmarrja aktive në projekte të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar | 1,946,500.0 | 6,000 | 206,000 | 306,500 | 356,500 | 357,000 | 357,000 | 357,500 |
| | **Gjithsej** | 54,236,737.1 | **6,913,688** | **7,166,741** | **7,812,820** | **8,386,244** | **7,659,047** | **7,948,761** | **8,349,436** |

**Pasqyra 4. Financimi për synimin strategjik D - Formimi dhe zhvillimi profesional bashkëkohor (në 000 lekë)**

| Nr. | Veprimtari kryesore | Fondet e parashikuara për periudhën 2014-2020 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Harmonizohen udhëzimet për ZhP-në me kuadrin ligjor | - | 0 | | | | | | |
| 2 | Trajnohen specialistët e institucioneve qendrore dhe të njësive arsimore vendore dhe drejtuesit e shkollave ( çdo vit 400-500 punonjës dhe specialistë të DAR-ve , drejtorë të IA-ve) | 71,153.8 | 7,500 | 8,250 | 9,075 | 9,983 | 10,981 | 12,079 | 13,287 |
| 3 | Zhvillohen kapacitetet për vlerësimin e nevojave për ZhP-në | 14,230.8 | 1,500 | 1,650 | 1,815 | 1,997 | 2,196 | 2,416 | 2,657 |
| 4 | Akreditohen programet bazuar në nevoja | - | | | | | | | |
| 5 | Trajnohen, certifikohen dhe licencohen periodikisht trajnerët (çdo vit 80-100 punonjës, specialistë, trajnerë) | 14,230.8 | 1,500 | 1,650 | 1,815 | 1,997 | 2,196 | 2,416 | 2,657 |
| 6 | Trajnohen, certifikohen dhe licencohen periodikisht mësuesit (çdo vit 4000-5000 punonjës me 3 deri në 5 ditë) | 474,358.6 | 50,000 | 55,000 | 60,500 | 66,550 | 73,205 | 80,526 | 88,578 |
| 7 | Krijohet sistemi për administrimin, për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave për ZhP-në (çdo vit 80-100 punonjës, specialistë) | 14,230.8 | 1,500 | 1,650 | 1,815 | 1,997 | 2,196 | 2,416 | 2,657 |
| 8 | Fuqizohen mekanizmat për qëndrueshmërinë e ZhP-së në shkollë | - | | | | | | | |
| | **Gjithsej** | **588,204.6** | **62,000** | **68,200** | **75,020** | **82,522** | **90,774** | **99,852** | **109,837** |

**Pasqyra 5. Fonde për APU-në për periudhën 2011-2020 , si dhe treguesit e financimit të APU-së për 2011-2020, në 000/ lekë**

| Artikujt | Realizimi | Realizimi | Realizimi | Buxheti I rishikuar | Buxheti I miratuar | Buxheti i miratuar me ligjin nr. 160/2014 për buxhetin 2016 - 2017 | | Parashikim PBA 2018-2020 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Periudha 201-2020** | **2011** | **2012** | **2013** | **2014** | ****2015** | **2016** | **2017** | **2018** | **2019** | **2020** |
| Paga (600-601) | 26,801,256 | 27,808,947 | 28,482,906 | 29,613,426 | 29,058,955 | 29,349,545 | 29,643,040 | 30,235,901 | 30,840,619 | 31,457,431 |
| Korrente të Tjera (602-606) | 1,177,055 | 1,343,144 | 1,455,666 | 2,182,223 | 1,394,166 | 1,400,000 | 1,400,000 | 1,428,000 | 1,456,560 | 1,485,691 |
| Kapitale (230-232) Të Brendshme | 1,487,157 | 1,650,790 | 1,862,713 | 4,015,360 | 1,999,500 | 2,880,000 | 4,026,000 | 4,106,520 | 4,188,650 | 4,272,423 |
| Kapitale (230-232) Të Huaja | 1,206,782 | 1,477,272 | 224,685 | 100,000 | 200,000 | 1,250,000 | 1,250,000 | 1,275,000 | 1,300,500 | 1,326,510 |
| Totali | 30,672,250 | 32,280,153 | 32,025,970 | 35,911,009 | 32,652,621 | 34,879,545 | 36,319,040 | 37,045,421 | 37,786,329 | 38,542,055 |
| Buxheti MASH ne % ndaj GDP | 2.36% | 2.43% | 2.36% | 2.53% | 2.19% | 2.19% | 2.11% | 2.07% | 2.03% | 1.99% |
| Jo Buxhetore | 60,447 | 32,146 | 17,156 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 20,000 |
| Totali | 30,732,697 | 32,312,299 | 32,043,126 | 35,931,009 | 32,672,621 | 34,899,545 | 36,339,040 | 37,065,421 | 37,806,329 | 38,562,055 |
| Fonde për arsimin nga NjBQV si dhe Ministritë e Linjës MMSR *** (2015) për APU | 0 | 0 | 0 | 2,500,000 | 4,451,300 | 4,575,000 | 4,648,000 | 4,800,000 | 4,900,000 | 5,100,000 |
| Fondet për APU + NJBQV + Min. Linjës | 30,732,697 | 32,312,299 | 32,043,126 | 38,431,009 | 37,123,921 | 39,474,545 | 40,987,040 | 41,865,421 | 42,706,329 | 43,662,055 |
| Fondet për APU në % ndaj GDP | 2.36% | 2.44% | 2.36% | 2.71% | 2.49% | 2.47% | 2.39% | 2.34% | 2.30% | 2.26% |
| Hendeku financiar i pa mbuluar I fondeve për APU / ose kërkesat për shtese fondesh | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,148,700 | 3,025,000 | 5,952,000 | 7,200,000 | 10,700,000 | 14,600,000 |
| **Fondet për APU + kërkesat shtesë** | **30,732,697** | **32,312,299** | **32,043,126** | **38,431,009** | **39,272,621** | **42,499,545** | **46,939,040** | **49,065,421** | **53,406,329** | **58,262,055** |
| Fondet për APU në % ndaj GDP | 2.36% | 2.44% | 2.36% | 2.71% | 2.63% | 2.66% | 2.73% | 2.75% | 2.87% | 3.01% |
| SEKTORI I ARSIMIT + Të ardhurat IAL | 42,233,069 | 45,529,594 | 46,203,837 | 48,261,880 | 50,983,418 | 54,463,400 | 59,259,592 | 61,259,593 | 65,259,594 | 70,259,595 |
| Buxheti ne % ndaj GDP | 3.24% | 3.43% | 3.40% | 3.40% | 3.42% | 3.41% | 3.45% | 3.43% | 3.51% | 3.64% |
| Hendeku Financiar / Kërkesa shtese për te arritur synime "Fondet për Arsimin ne 5 % te PBB" | | 0 | 0 | 2,600,000 | 10,600,000 | 13,600,000 | 17,600,000 | 21,600,000 | 25,600,000 | 26,600,000 |
| Fondet për Arsimin se bashku me kërkesat shtese për synim 5 % | 42,233,069 | 45,529,594 | 46,203,837 | 50,861,880 | 61,583,418 | 68,063,400 | 76,859,592 | 82,859,593 | 90,859,594 | 96,859,595 |
| Buxheti ne % ndaj GDP me kërkesat shtese* | 3.24% | 3.43% | 3.40% | 3.59% | 4.13% | 4.26% | 4.47% | 4.64% | 4.89% | 5.01% |
| GDP mije leke VKM 433 DT 2.7.2014 & ligji 160/2014 | 1,301,750,000 | 1,326,169,000 | 1,358,000,000 | 1,418,000,231 | 1,492,070,000 | 1,596,037,000 | 1,718,079,000 | 1,786,802,160 | 1,858,274,246 | 1,932,605,216 |
| Shpenzime publike ne mije leke, VKM 433 DT 2.7.2014 | 376,300,000 | 376,241,000 | 409,594,000 | 456,403,857 | 474,996,612 | 487,945,000 | 497,572,000 | 517,474,880 | 538,173,875 | 559,700,830 |
| Buxheti MASH ne % ndaj SH Publike | 8.17% | 8.59% | 7.82% | 7.87% | 6.88% | 7.15% | 7.30% | 7.16% | 7.02% | 6.89% |
| Buxheti MASH +Te Ardh ne % ndaj SH Publ | 8.17% | 8.59% | 7.82% | 8.42% | 8.27% | 8.71% | 9.43% | 9.48% | 9.92% | 10.41% |
| Buxheti Sektorit Arsimit + Ardhurat ne % ndaj SH Publ | 11.22% | 12.10% | 11.28% | 11.14% | 12.97% | 13.95% | 15.45% | 16.01% | 16.88% | 17.31% |

# 5 SEKSIONI

## RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Matja e ndikimit të politikës arsimore me më shumë rigorozitet dhe vazhdimisht, do të prodhojë kosto më efektive për një kohë më të gjatë. Ndaj, në dokument i kushtohet vëmendje e posaçme fuqizimit të monitorimit dhe të vlerësimit. Kjo, me qëllim që:

- të mblidhen të dhëna për të raportuar, për të publikuar dhe për të komunikuar në kohë rezultatet dhe nismat, si dhe për t'i analizuar dhe për t'i shfrytëzuar ato në hartimin e politikave dhe në vendimmarrje;
- të çmohet përparimi i sistemit arsimor.

Ministria po punon për të përmirësuar kapacitetin për menaxhimin e informacionit të performancës (sidomos të SMIA-s) dhe për të ndërtuar kapacitetin për raportimin e performancës së SAPU-së, sidomos të performancës financiare në nivelin e mesëm. Prandaj, fuqizimi i SMIA-s, bazuar në TIK, do të jetë përparësi, sidomos në këtë nivel.

Zbatimi i SZhAPU-së filloi në vitin 2014.

Ministria do të hartojë planin paraprak të zbatimit, ose një udhërrëfyes, me afatet kohore dhe me veprimet përkatëse, që të realizohen si duhet përgatitjet për zbatimin e strategjisë.

Planifikimi i hershëm është vendimtar për bashkërenditjen e nevojshme të përpjekjeve me partnerët, për të siguruar kështu mbështetjen e duhur.

## ❖ Korniza e monitorimit

Monitorimi sistematik lejon gjenerimin e informacionit dhe reflektimin. Monitorimi i Strategjisë do të përfshijë shqyrtimin e rregullt të burimeve, të produkteve dhe të rezultateve të ndërhyrjeve politike. Ai bazohet në sistemin e treguesve të performancës, të ngjashëm me sistemet e treguesve europiane dhe në analizën e tyre si dhe në objektivat e planeve institucionale të zhvillimit.

Për sistemimin e informacionit të monitoruar përgjigjet MAS-i. Ky informacion do të përshkruajë me hollësi aktivitetet e kryera dhe rezultatet e arritura. Objektivat dhe produktet e Strategjisë do të bëhen funksionale nëpërmjet Planit të Veprimit dhe dokumenteve të tjera të planifikimit tematik. Zbatimi i Planit të Veprimit do të mbikëqyret nëpërmjet treguesve të arritjeve, të cilët matin rezultatet e programeve aktive, caktojnë përgjegjësitë për zbatim dhe përcaktojnë burimet financiare.

Në funksion të këtij procesi vihen sistemet informatike që monitorojnë në kohë reale ecurinë e sistemit të treguesve dhe ndihmojnë, kështu, hartimin e politikave dhe vendimmarrjet.

Për këtë, hartimi i Kornizës së monitorimit është pjesë thelbësore e zbatimit të Strategjisë.

Sistemi i monitorimit i propozuar bazohet në elementet kryesore, si në vijim:

- **Korniza e monitorimit:** Do të përcaktohet një Kornizë më e detajuar e monitorimit për secilën përparësi të politikës, menjëherë pas fazës fillestare të zbatimit.

- **Plani vjetor i zbatimit:** Matricat për çdo përparësi të politikës ofrojnë udhëzimet e duhura për përgatitjen e planeve vjetore. Është e domosdoshme të përshtaten vlerësimet fillestare të planeve, në përputhje me efektivitetin e procesit të ndërtimit të kapaciteteve të Ministrisë dhe me fondet në dispozicion.

- **Të dhënat fillestare:** Të dhëna për vitin 2013 do të përdoren si pika fillestare për matjen e përparimit në të ardhmen dhe do të shërbejnë si bashkësia e të dhënave për monitorimin e performancës së SAPU-së.

Monitorimi do të realizohet nga Ministria dhe palët e përfshira, përgjatë periudhës 2014-2020.

Gjithashtu, një grup më i zgjeruar treguesish do të gjenerohen dhe monitorohen përmes sistemeve informatike (Shtojca 1, tabela 11). Treguesit do të ndiqen rregullisht, duke marrë masat e duhura, që të sigurohen të dhëna të besueshme për palët e përfshira, në nivelin qendror dhe në atë të mesëm.

Për të siguruar reagim të shpejtë ndaj tendencave të vërejtura nga të dhënat e mbledhura, do të ndërmerret çdo veprim i domosdoshëm politik. Udhëheqja e Ministrisë përgjigjet për reagimin në kohën e duhur.

Është me rëndësi që, qysh në fazën e hershme të jetësimit të SZhAPU-së, të rishikohet dhe, sipas nevojës, të zvogëlohet numri dhe / ose shtrirja e treguesve, që ata të jenë më të përdorshëm.

## Korniza e vlerësimit të performancës (KVP)

Ministria do të krijojë KVP-në e SAPU-së, të ndërlidhur me sistem të përmirësuar të SMIA-s.

KVP-ja do t’u shërbejë palëve të përfshira për matjen e përparimit gjatë zbatimit të Strategjisë. Thelbi i KVP-së qëndron në përkufizimin e kritereve të vlerësimit për rezultatet e pritshme sipas përparësive të politikës, si dhe për rezultatet në nivelin e Strategjisë.

Treguesit e performancës do të përdoren nga Ministria, nga partnerët dhe nga palët e përfshira si mjet matjeje për ndikimin dhe rezultatet, krahasuar me burimet e përdorura gjatë vlerësimit të performancës së SAPU-së. Secili program i përparësive të politikës përmban rezultatet që pritet të realizohen deri në vitin 2020.

Duhen vlerësuar si proceset, ashtu edhe tendencat e rezultateve. Matja e realizimit të rezultateve arsimore dhe e performancës së SAPU-së kërkon zhvillimin e treguesve (indikatorëve) kryesorë për vlerësimin periodik të përparimit në drejtim të rezultateve të pritshme të secilës përparësi.
Monitorimi i SAPU-së shtrihet mbi disa komponentë:

1. Tendencat kryesore sipas përparësive dhe vështirësitë.
2. Tendencat në standardet e të nxënit dhe vështirësitë.
3. Arritjet dhe vështirësitë në zbatimin e politikave.
4. Financimi i sektorit dhe vështirësitë.

Komponentët 1 dhe 2 janë tregues kyç të strategjisë dhe trajtohen nga treguesit kryesorë të paraqitur në tabelën 7 (shtojca 1). Komponentët 3 dhe 4 janë çështje të politikave e të proceseve. Matrica e monitorimit të efikasitetit të zbatimit të politikave është dhënë në tabelën 6.

**Tabela 6. Matrica për monitorimin e efikasitetit të politikave**

| ASPEKTET | PYETJE ORIENTUESE |
|---|---|
| **Rezultatet e SZhAPU-së** | • Si funksionon SAPU-ja në kuptimin e përparësive politike të SZhAPU-së?<br>• A është SZhAPU-ja në rrugë të mirë për të arritur rezultatet e pritshme?<br>• Cilat kanë qenë arritjet më të mëdha gjatë periudhës njëvjeçare për secilën prej përparësive?<br>• Cilat janë rezultatet kryesore të arrira nga SZhAPU-ja gjatë vitit përkatës (bazuar në planin vjetor)?<br>• Çfarë rishikimesh, studimesh dhe vlerësimesh janë kryer dhe çfarë rezultatesh kanë dhënë ato?<br>• A ka nevojë të ndryshohen përparësitë e SZhAPU-së? |
| **Proceset e SZhAPU-së** | • Cila është përmasa e financimit nga qeveria dhe nga partnerët që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, lidhen me përparësitë e politikës?<br>• Sa është e fuqishme pronësia mbi SZhAPU-në nga palë të ndryshme të përfshira?<br>• Deri në çfarë mase i përdorin partnerët sistemet qeveritare të buxhetit, shpenzimeve, kontabilitetit dhe raportimit? Cili ka qenë ndikimi?<br>• Sa i përshtatet ndarja e tanishme e buxhetit mes përparësive të projektuara?<br>• Cilat janë tendencat e shpenzimit në administratë, nëpër zonat e përparësive, shpenzimet jashtë pagave në nivel shkolle dhe asistenca teknike si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme dhe cilat janë pasojat e kësaj?<br>• Deri në çfarë mase e ka zvogëluar koordinimi i donatorëve barrën e menaxhimit të donatorëve nga Ministria?<br>• Çfarë përparimi është bërë kundrejt parimeve të strategjisë për barazinë gjinore, për arsimin gjithëpërfshirës dhe arsimimin e të varfërve? |

Ministria do të hartojë një **doracak** për zbatimin e Strategjisë, i cili do t'u nënshtrohet rishikimit, plotësimit dhe përmirësimit, sa herë që të lindë nevoja.

Në nivelin e SAPU-së, Ministria do të jetë përgjegjës për koordinimin e procesit të rishikimit të performancës së sistemit, raportimin për palët me interes në nivel të lartë (ministrive dhe partnerëve) dhe procesin e negociatave e të rishikimit strategjik me palët e interesuara.

Njësitë arsimore vendore do të menaxhojnë aspektet teknike të monitorimit të performancës, duke hartuar raportet e ndikimit dhe ato të ecurisë së programeve e të projekteve të ndryshme mbështetëse dhe të burimeve të tjera të informimit.

Veç monitorimit të përparësive, do të parashikohen dhe udhëzime për çështje të caktuara, për të cilat mund të kërkohet monitorim i veçantë. Kjo thekson nevojën për një numër treguesish themelorë, për ndjekje të vazhdueshme dhe për raportim, çka do të siguronte kapjen në kohë të shfaqjes së rrethanave të papritura.

Kur të paraqitet nevoja për ndërhyrje specifike në përparësitë e politikës (veprimtari shtesë, por plotësuese), disa tregues mund të përshtaten, për të ruajtur llogaridhënien e sistemit.

# SHTOJCA 1

# TREGUESIT
# PËR MINTORIMIN DHE VLERËSIMIN
# E PROGRESIT TË STRATEGJISË

**Tabela 7. Treguesit kryesorë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të Strategjisë**

| PËRSHKRIMI I TREGUESVE | GJENDJA 2013 | SYNIMI 2017 | SYNIMI 2020 |
|---|---|---|---|
| **QEVERISJA, UDHËHEQJA DHE KAPACITETET MENAXHUESE TË BURIMEVE** | | | |
| Funksionimi i SMIA-s në nivelin qendror | Jo funksional | Funksional | Funksional |
| Funksionimi i SMIA-s në nivelin e mesëm | Jo funksional | Funksional | Funksional |
| Funksionimi i SMIA-s në nivelin e IA-së | Jo funksional | Funksional | Funksional |
| Përdorimi i SMISh për rrjetin kombëtar të shkollave | Jo funksional | 50% | 100% |
| IA-të që përdorin standardet e performancës për vlerësim | 0% | 50% | 100% |
| Paga mesatare për mësues në arsimin bazë (në mijë lekë) | 54.2 | 55 | 59.6 |
| Paga mesatare për mësues në arsimin e mesëm (në mijë lekë) | 61.3 | 62 | 67.4 |
| Buxheti i arsimit në raport me PBB-në (në përqindje) | 3.4 | 4.47 | 5.01 |
| Buxheti i arsimit në raport me shpenzimet publike (në %) | 11.28 | 15.45 | 17.31 |
| Buxheti i arsimit parauniversitar ndaj PBB-së (në %) | 2.36 | 2.73 | 3.01 |
| Buxheti i arsimit parauniversitar ndaj shpenzimeve publike (në %) | 7.82 | 9.43 | 10.39 |
| Shpenzimet për nxënës në arsimin parauniversitar në mijë lekë | 610 | 920 | 1,100 |
| Fonde për shpenzime për personelin , ndaj buxheti vjetor te MAS në % | 81.4 | 77 | 75 |
| Fonde për shpenzime korrente ,ndaj buxheti vjetor te MAS në % | 9.9 | 11 | 11 |
| Fonde për shpenzime kapitale, ndaj buxheti vjetor te MAS në % | 8.7 | 12 | 14 |
| **NXËNIE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE CILËSORE** | | | |
| Numri i fëmijëve në APSh publik | 76411 | 78000 | 78500 |
| Numri i fëmijëve në APSh privat | 5032 | ND | ND |
| Numri i fëmijëve që përfshihen në klasa përgatitore | 11687 | 12000 | 12500 |
| Raporti fëmijë për një edukatore | 18.25 | 18 | 18 |
| Numri i mësuesve ne APSh publik | 4144 | 4232 | 4260 |
| Numri i mësuesve ne APSh privat | 318 | ND | ND |
| Përqindja e fëmijëve te klasës se pare qe vijnë nga kopshti | 84% | 90% | 100% |
| Përqindja e fëmijëve ne kopshte me ushqim | 23% | 25% | 28% |
| Mësuese me arsim përkatës ne kopshte | 70% | 90% | 100% |
| Numri i kopshteve qytet | 426 | 446 | 560 |
| Numri i kopshteve fshat | 1474 | 1600 | 1800 |
| Numri i nxënësve për APU | 619459 | 570000 | 560000 |
| Numri i shkollave sipas niveleve në APU | 3600 | 3500 | 3400 |
| Numri i klasave sipas niveleve në APU total | 20557 | 20300 | 20200 |
| Numri i mësuesve sipas niveleve ne APU total | 38119 | 39000 | 39500 |
| Numri i shkollave në arsimin baze publik | 1340 | 1330 | 1320 |
| Numri i/klasave në arsimin bazë publik | 14151 | 14000 | 13950 |
| Numri i nxënësve në arsimin bazë publik | 356347 | 340000 | 330000 |
| Numri i mësuesve në arsimin bazë publik | 23269 | 23100 | 23000 |
| Numri i shkollave në arsimin baze privat | 124 | 120 | 120 |
| Numri i klasave në arsimin bazë privat | 1263 | 1200 | 1200 |
| Numri i nxënësve në arsimin baze privat | 20727 | 21000 | 21000 |
| Numri i mësuesve në arsimin baze privat | 1782 | 1700 | 1700 |
| Numri i shkollave/ në gjimnaze publike | 332 | 335 | 340 |
| Numri i klasave në gjimnaze publike | 3217 | 3300 | 3350 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i nxënësve në gjimnaze publike | 107948 | 110000 | 112000 |
| Numri i mësuesve në gjimnaze publike | 5446 | 5500 | 5500 |
| Numri i shkollave në gjimnaze private | 115 | 115 | 115 |
| Numri i klasave në gjimnaze private | 647 | 650 | 650 |
| Numri i nxënësve në gjimnaze private | 16671 | 17000 | 17000 |
| Numri i mësuesve në gjimnaze private | 1290 | 1300 | 1300 |
| Tërheqja në arsimin e mesëm | 96 % | 97% | 97% |
| Numri i konvikteve në funksionim | 50 | 53 | 55 |
| Numri i nxënësve konviktorë | 2921 | | |
| Numri i vendeve të lira në konvikte | 2642 | | |
| Numri i nxënësve me AK në arsimin e zakonshëm (APU) | 3201 | 3600 | 4000 |
| Numri i nxënësve me AK në Institute speciale | 704 | 800 | 900 |
| Numri i bibliotekave shkollore të lidhura me internet | ND | 40% | 100% |
| Numri i kompjuterëve, i laptopëve dhe i tabletave | 11331 PC<br>1199 laptopë | 12500 PC<br>1600 laptopë<br>12000 tableta | 14000 PC<br>2500 laptopë<br>24000 tableta |
| Numri i shkollave me faqe interneti | 50 | 500 | 150 |
